

UNIVERSITETIT I EVROPËS JULINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME BURGIM NDAJ TE MITURVE SIPAS TË DREJTËS POZITIVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KANDIDATI:

Besnik BAFTIU

MENTORI:

Prof. dr. Jeton SHASIVARI

Tetovë, 2018

PËRMBAJTJA

<i>SHKURTESAT</i>	4
HYRJE.....	6
<i>a. Objekti dhe arsyet e studimit</i>	7
<i>b. Metodat e studimit</i>	8
<i>c. Struktura e punimit</i>	9
KAPITULLI I DISA VESHTRIME MBI PERKUFIZIMIN DHE RËNDËSINË E SANKSIONEV PENALE NDAJ TË MITURVE	10
1 Roli i sanksioneve penale ndaj te miturve	10
2 Llojet e sanksioneve penale që shqiptohen ndaj te miturve.....	13
2.1 Masat e diversitetit.....	16
3 Masat Edukative	19
3.1 Masat Disiplinore.....	20
3.2 Masat edukative të mbikëqyrjes së shtuar.....	21
3.3 Masat edukative institucionale	22
4 Dënimi me gjobë.....	24
5 Dënim me urdhër për pune në dobi të përgjithshme	26
6 Dënimi me kusht.....	28
7 Dënimet plotësuese.....	30
KAPITULLI II – VËSHTRIM I VEÇANT MBI EKZEKUTIMIN E DËNIMIT ME BURGIM	32
1 Ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të miturve	32
2 Qëllimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të miturve	35
3 Pranimi i te miturve ne qendrën korrektuese	37
4 Kategorizimi i personave të mitur gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim	39
KAPITULLI III – ASPEKTET E SIGURISË TË SHQIPTIMIT TE DËNIMIT ME BURGIM	41
1 Procedura për shqiptimin e dënimit me burgim ndaj te miturve	41
2 Arrestimi dhe paraburgimi i të miturit	45
3 Matja e dënimit me burgim.....	46
4 Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burgim	48
5 Lirimi me kusht	49
KAPITULLI IV - VËSHTRIMI KRAHASIMOR I SANKSIONEV PENALE NDAJ TË MITURVE NË KOSOVË ME MAQEDONIEN DHE SHQIPËRINË	51
1 Sanksionet penale ndaj të miturve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Maqedonisë	52

2	Procedura për ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj të miturve në institucionet korrektuese të Republikës së Maqedonisë	55
3	Sanksionet penale ndaj të miturve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës Shqipërisë.....	57
4	Procedura për ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj të miturve në entet edukative përmirësuese të Republikës së Shqipërisë	62
	<i>PËRFUNDIMI</i>	66
	<i>REKOMANDIMET</i>	67
	<i>LITERATURA</i>	68

SHKURTESAT

KDM - Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

KDF - Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

APOKB - Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuar.

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuar.

UR - Udhëzimet e Riadit.

EU- Unioni Evropian.

LPM - Ligjin Penal për të Mitur.

RK- së - Republikës së Kosovës.

GIZ - Organizata Gjermane.

G.Z.K-së - Gazetën Zyrtare të Kosovës.

SHSK-së - Shërbimi Sprovues i Kosovës.

RRSMTB- Rregullat Standarde Minimale për Trajtimin e të Burgosurve.

KTDMÇD - Konveta kundër Torturës dhe Dënimeve a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese.

DUDN - Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.

ASK-së - Agjensioni i Statistikave të Kosovës.

SJK-së - Statistikat e Jurisprudencës të Kosovës.

KPK-së, - Kodi Penal i Kosovës.

KPPK-së, - Kodi i Procedurës Penal.

LESPK-së - Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale i Kosovës.

SHBA-së – Shtete e Bashkuar të Amerikës.

QKL - Qendrën Korrektuese ne Lipjan.

KOMF - Koalicioni i OJQ për mbrojtjen e fëmijëve.

QKRMT - Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës.

BE-ja – Bashkimi Evropian.

KDF - Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve

UNMIK - Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

PLK - Paneli për Lirim me Kusht.

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme.

LDMM-së - Ligjit mbi drejtësinë për të mitur i Maqedonisë.

RM-së - Republika e Maqedonisë.

KPM-së – Kodi Penal i Maqedonisë.

KPSH-së - Kodin Penal të Shqipërisë.

KDPMSH-së - Kodi i Drejtësisë Penale për të mituri i Shqipërisë.

SHP - Shërbimi i Provës.

IEVP - Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

ME – Masat Edukative.

MD-Masat Disiplinore.

HYRJE

Drejtësia për të mitur ka rrugën e vetë të evoluimit dhe transformimit rrënjësor të shqiptimit të sanksioneve ndaj të miturve por edhe të trajtimit të tyre gjatë vuajtjes së dënimit me burgim apo gjatë ekzekutimit të ndonjë mase. Ky zhvillim është arrit si rezultat i depërtimit të shkollave të ndryshme që kanë trajtu problematikën e delikuencës së të miturve. Në këtë drejtim, edhe pse Kosova është shtet i ri, ka arrit që legjislacionin për trajtimin e të miturve të harmonizoj me standardet ndërkombëtar. Edhe përkundër të rregullimit të infrastrukturës ligjore nga shumë organizata ndërkombëtare dhe kombëtare sistemi penitensiar i të miturve kritikohet shumë, sidomos në realizimin e të drejtave të të miturve gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale. Dhe në këtë kontekst do të behet fjalë lidhur me problemet që paraqiten gjatë ekzekutimit me burgim ndaj të miturve sipas Kodit të Drejtësisë për të mitur dhe dënimeve të tjera ndaj të miturve. Studimi i punimit rreth trajtimit të ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të miturve, është një çështje aktuale me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare. Pasi për kryerësit e veprave penale, përveç përcaktimit të masave që mund t'i shqiptohen ndaj të miturve, është parapa edhe dënimi me heqje të lirisë ndaj të miturve sipas të drejtës pozitive të Republikës së Kosovës. Kodi i drejtësisë për të mitur i Kosovës ka parapare sanksione të ndryshme ndaj të miturve ,varësisht se çfarë lloji të veprës penale kanë kryer, rrezikshmërisë shoqërore, rrethanave se si është kryer etj. Vepra penale dënohet dhe që të konsiderohet penale duhet të jete e rrezikshme për shoqërinë si dhe e kundërligjshme dhe për atë shqiptohen sanksione penale ndaj delikuentëve. Sanksionet penale ndaj të miturve janë pjese përbërëse e sanksioneve penale në përgjithësi, mirëpo për shkak të moshës së të miturve ata kanë një trajtim tjetër, e ky trajtim është me i bute dhe me i favorshëm në krahasim me personat madhore, sepse ata akoma nuk e kanë evoluar sa duhet vetit, karakteristikat dhe cilësitë fizike po ashtu edhe ato psikike, sepse, të rinjtë nuk mund të kuptojnë dhe të kontrollojnë si duhet veprimet apo mosveprimet e veta. Sanksionet ndaj të miturve janë trajtuar në ligje të veçanta sipas standardeve të Evropës Perëndimore si dhe në varësi të kushteve, rrethanave sociale, ekonomike dhe realitetit në shoqëror.

a. Objekti dhe arsyet e studimit

Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale. Sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës të personat e mitur që merren me sjellje deviante mund t'iu shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative. Privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjatë kohës së privimit nga liria, çdo legjislacion bashkëkohor por edhe legjislacioni pozitiv i Kosovës përcakton një trajtimit të veçantë për delinkuentin e mitur, kjo vjen për arsye se i mituri akoma nuk e ka arritur pjekurinë fizike dhe psikike dhe si i till nuk posedon aftësi për kontrollimin e veprimeve dhe sjelljeve të tij, nëse, e trajtojmë aspektin komperativ me delikuentet e rritur. Gjatë elaborimit të punimit do të mundohem me i dhënë përgjigje pyetjeve si: Cili është qëllimi i dënimit me burgim për të mitur sipas Kodit të drejtësisë për të mitur dhe ky qëllim a është i harmonizuar me traktatet ndërkombëtare? Ekzekutimi i dënimit me burgim dhe trajtimi i të miturve a bëhet në përputhje me të drejtën pozitive të Kosovës? Ekzekutimi i dënimit me burgim për të mitur a bëhet në frymën e riedukimit dhe risocializimit? A ekziston dallime dhe përputhje lidhur me ekzekutimin e sanksioneve penale ndaj të miturve me vendet e rajonit” Të gjitha pyetjeve të lartcekura do t'i jepet përgjigje gjatë trajtimin të tezës së punimit.

b. Metodatat e studimit

Më qëllim që një punim i masterit ti përbush të gjitha kriteret e parapara dhe standardet më të larta të punës kërkimore shkencore, patjetër që duhet të ketë një metodologji apo rrugë deri te ardhja e së të vërtetës. Tema “Ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të miturve sipas të drejtës pozitive të Republikës së Kosovës”, është një punim që i duhet një qasje dhe metodologji interdisiplinare, më qëllim që të arrihet deri të e vërteta dhe identifikim i problemeve në praktikën lidhur me ekzekutimin e sanksioneve penale ndaj të miturve.

Gjatë hartimit dhe punimit të temës janë përdorur disa metoda që kanë qenë të nevojshme për hulumtimin dhe kërkimin e të dhënave dhe informacioneve të duhura lidhur me aplikimin dhe analizën e problematikës së ekzekutimit të dënimit me burgim.

Nga metodatat e mundshme që janë përdorur në këtë punim janë: metoda juridike, metoda komparative – krahasuese, dhe metoda historike

Më anë të metodës juridike është bërë e mundur njohja dhe studimi i legjislacionit penale të Republikës së Kosovës. Përmes kësaj metode kemi arritur të njohim rregullimin ligjorë të ekzekutimit të sanksioneve ndaj të miturve në Republikën e Kosovës.

Përmes metodës komparative – krahasuese, jemi mundur që t’i njohim dhe ti studiojmë pikat e përbashkëta dhe dallimet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe disa shteteve të rajonit lidhur shqiptimin dhe ekzekutimin e sanksioneve ndaj të miturve.

Ndërsa përmes metodës historike, kemi trajtu disa sanksione që janë shqiptu ndaj të miturve gjatë periudhave të ndryshme historike.

c. Struktura e punimit

Punimi “Ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të miturve sipas të drejtës pozitive të Republikës së Kosovës”, përpos hyrjes përbëhet prej katër kapitujve kryesor, ku secili kapitull trajton çështjet kryesore të ekzekutimit të sanksioneve penale ndaj të miturve.

Në kapitullin e parë me titull: SANKSIONET PENALE NDAJ TË MITURVE SIPAS KODIT TË DREJTËSISË PËR TË MITUR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, do të elaborhet e drejta pozitive e Kosovës. Gjithashtu do të ketë të dhëna dhe statistika mbi shqiptimin e të gjitha sanksioneve penale ndaj të miturve.

Në kapitullin e dytë me titull: VËSHTRIMI I VEÇANTE MBI EKZEKUTIMIN E DËNIMIT ME BURGIM, do të trajtohet ekzekutimi i sanksioneve penale ndaj të miturve, qëllimi i dënimit me burgim sipas të drejtës pozitive dhe sipas akteve ndërkombëtare. Po ashtu do të analizohet edhe pranimi i të miturve në qendrat korrektuese dhe kategorizimi i tyre sipas legjislacionit të Kosovës.

Në kapitullin e tretë me titull: ASPEKTET E SIGURISE TË SHQIPTIMIT TE DËNIMIT ME BURGIM, analizohet proceduara lidhur me ekzekutimin e sanksioneve ndaj të miturve. Gjithashtu rëndësi të veçantë do t’i kushtohet arrestimit dhe paraburgimit ndaj të miturve si një ndër masat më kurciale për zhvillimin e një procedure efikase dhe efektive nda të miturve.

Në kapitullin e katërt me titull: VËSHTRIMI KRAHASIMOR I SANKSIONEVE PENALE NDAJ TE MITURVE NE KOSOVE ME MAQEDONINE DHE SHQIPERINE, do të analizohen pikat e përbashkëta dhe dallimet ndërmjet legjislacionit pozitiv të Kosovës me vendet e rajonit, në veçanti do të trajtohet e drejta pozitive e Maqedonisë lidhur me problematikën e ekzekutimit të sanksioneve penale ndaj të miturve dhe e drejta pozitive e Shqipërisë lidhur me problematikën e ekzekutimit të sanksioneve ndaj të miturve.

Po ashtu do të mundohem të analizoje dhe të nxjerrë përfundimin dhe rekomandimet e nevojshme lidhur me përmirësimin dhe legjislacionit ndaj të miturve në Republikën e Kosovës.

KAPITULLI I DISA VESHTRIME MBI PERKUFIZIMIN DHE RËNDËSINË E SANKSIONEV PENALE NDAJ TË MITURVE

1 Roli i sanksioneve penale ndaj te miturve

Në përgjithësi kriminaliteti i të miturve paraqet problem kompleks dhe social dhe është pjese përbërëse e kriminalitetit në përgjithësi.¹ Njohja, parandalimi dhe luftimi i kriminalitetit të të miturve² ka një rëndësi me të madhe se sa luftimi i kriminalitetit të të rriturve. Luftimi dhe prevencioni i sjelljeve deviante dhe asociale³ në kohën bashkëkohore, është parakusht se shoqëria do të ketë një të ardhme me të ndritur për rinin dhe krimi do të jete me pak i ekspozuar, pra kjo luftë nga mekanizmat institucional duhet të jetë parësore. Kriminaliteti i te miturve është pjese e kriminalitetit të përgjithshëm, mirëpo për shkak të shume specifikave të kryerësve të mitur të veprave penale e sidomos për moshën e tyre si dhe aspekteve sociologjike, psikologjike, juridike etj, është treguar mese e domosdoshme qe kriminaliteti i te miturve të trajtohet ndaras nga kriminaliteti i personave madhore.⁴ Për këtë arsye ndaj personave të mitur të zbatohen masa të veçanta juridiko- penale të cilët dallojnë nga personat madhore. Pra, çdo vend i ka konceptet e veta specifike të nocionit të sjelljeve sociopatologjike të të miturve dhe kufi të ndryshëm moshash. Ky nocion dallohet nga vendi në vend, në disa vende ka dallime edhe në emërtime si sjellje sociopatologjike, ndërsa, në disa vende të tjera fare nuk ekziston një emërtim i tillë⁵, por emërtimet e delikuencës së të miturve pothuajse në gjithë botën bashkëkohor ekzistojnë emërtime të tilla që janë kushtëzuar nga vetë sistemi edukativ, kulturor, ekonomik dhe politik.

Te miturit delikuent kanë forme të veçante por edhe të rrezikshme për shoqërinë dhe vlerave shoqërore të cilat janë të mbrojtura me ligje.⁶ Delikuentet⁷ e mitur paraqesin kategori të

¹ Zeneli, Ismail¹, Kriminaliteti i të miturve dhe trafikimi i drogës në Maqedoni, të botuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Revista "E drejta", nr. 3/2003, Prishtinë, fq. 92.

² Me nocionin i "Mitur", duhet të kuptohet kategoria e personave që përfshinë moshën 14-18 vjeç.

³ Me sjellje deviante dhe asociale duhet të nënkuptojmë të gjitha veprimet dhe aktivitete të cilat nuk janë në pajtim me rregullat apo normat e mirësjelljes në shoqëri.

⁴ Salihu, Ismet¹, E drejta Penal për të mitur, Prishtinë, 2010, fq. 11.

⁵ Zejneli, Ismail², Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë, Tetovë, 2010, fq. 19.

⁶ Ukaj, Bajram, Sanksionet penale ndaj të miturve në Ligjin penal për të mitur të Kosovës të vitit 2004, , Revista, E drejta, nr.1-2/2008, fq. 94, të botuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës.

⁷ Sipas, Halili, Ragip¹, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 22. Me delikuencë kuptojmë të gjitha veprimet dhe sjelljet që më dispozita ligjore positive të një vendi janë të ndaluar e të cilat emërtohen si delikte. Zakonisht, kur përdoret termi delikuencë, mendohet për disa sjellje e shkelje të këtyre normave, e të cilat nuk janë të rënda si krimet dhe veprat penale.

posaçme dhe se trajtimi i tyre penalo-juridik behet ndaras nga delikumente madhore për te cilin e kane te rregulluar me Kod te veçante, d.m.th, me Kodin e Drejtësisë për te mitur (këtë Kod në vijim do të përdoret shkurtesa - KDM). Numri i krimeve të kryera nga delikumentet është shume i madhe dhe për fate te keq dita ditës po tregona tendenca të rritjes .Sipas statistikave pjesëmarrja e te miturve është ne një përqindje të madhe varësisht nga shtetet.⁸ Kështu qe duhet të bëhen kërkime empirike dhe shkencore me qëllim arrihet të ulja e numrit te krimeve nga të miturit. Duhet qe te behet integrimi i tere fëmijëve dhe te rinjve përmes familjes, grupeve te shokëve, shkollave, komuniteteve, aftësive profesionale dhe punës, organizatave humanitare etj.⁹

Pozita penalo-juridiko e të miturve është një rrethanë që kushtëzon zbatimin e masave të legjislacionit penal si mjet i fundit në luftimin e delikuencës së të miturve. Legjislacioni penale, edhe pse dukshëm e ka rregulluar pozitën penalo juridiko të të miturve, nuk ka arritur sa duhet të ndikojë në luftimin dhe parandalimin efikas dhe efektiv të kësaj dukuri negative. Mirëpo, këto norma juridike nuk do të kenë efekt kriminalo-politik nëse nuk bëhen ndryshime radikale si në aspektin kadrovik, organizativ, të zbulimit, gjykimit të të miturve dhe ekzekutimin e masave edukative¹⁰ dhe të dënimit me burgim.

Pjesëmarrja e krimeve qe i kryejnë të miturit me te fokusara janë ne kriminalitetin kundër pasurisë, siç janë: veprat penale kundër vjedhjes, vepra penale kundër jetës dhe trupit apo kundër njeriut ku bëjnë pjesë rrahjet apo pjesëmarrja në rrahje. Viteve të fundit, jo pak grupe të të miturve kane filluar të merren me veprime kriminale te peshës se rëndë, siç janë: terrorizmi politik qe paraqitet dhe ushtrohet mbi baza kombëtare dhe religjioze. Me te përhapura janë në Gjermanin Lindore, Rusi dhe në shume vende te tjera ku përveç aktiviteteve kriminale merren edhe me maltretimet dhe ndjekjen e grupacioneve dhe popujve ne forma te veçanta nacionale dhe etnike.¹¹ Numri i delikumenteve është mjaftë i madhe, ku studimet tregojnë se ky fenomen është i identifikuar me disa veçori në krahasim me kriminalitetin e të rriturve.¹² Delikuenca e të miturve është një dukuri mjaftë e rrezikshme për shoqërinë ne tërësi sepse këta te mitur ne te ardhmen mund te jene kriminel potenciale ne qofte se nuk trajtohen me kohe ne mënyrat me te

⁸ Salihu¹, fq. 11.

⁹ Shih: Udhëzimet Kombeve të Bashkuar për parandalimin e delikuencës së të miturve (Udhëzimet e Riadit), të miratuar dhe të shpallur me Rezolutën 45/112 të Asamblesë së Përgjithshme më 14 dhjetor 1990, sesioni 68-të plenar.

¹⁰ Zejneli², fq. 23.

¹¹ Hajdar, Azem, E drejta e procedurës penale e të miturve, Prishtinë, 2005, fq. 16-18.

¹² Halili¹, fq. 224-228.

mira në drejtim të riintegritimit dhe risocializimit të tyre¹³, që ata të kenë një jetë normale. Kjo bazohet në faktin se shumica e recidivisteve (përsëritësve të krimit) janë pikërisht personat të cilët për herë të parë kanë kryer vepra penale në moshe të mitur. Kjo dukuri negative mund të luftohet me sanksione penale të përshtatshme ndaj tyre, sepse përmes këtyre sanksioneve shoqëria mbrohet nga kriminaliteti, vlerat me të rëndësishme të individëve dhe të bashkësive shoqërore.

Me sanksione penale për të mitur, nënkuptojmë të gjitha llojet e sanksioneve penale ndaj të miturve njëhën prej mjeteve të cilat i ndërmerr shoqëria, dhe shteti për të mbrojtur personat, vlerat përgjithësisht, dhe shoqërinë nga kriminaliteti.¹⁴

Sanksionet penale janë masa të dhunshme penalo-juridike të cilat i shqipton gjykata me procedurat përkatëse me ligjin në fuqi ndaj kryerësve të veprave penale me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe individëve nga kriminaliteti si dukuri negative, që konsistojnë në marrjen apo kufizimin e lirisë apo disa të drejtave të caktuara, si dhe tërheqjen e vërejtjes për marrjen apo kufizimin e lirisë apo të drejtave në qoftë se kryen vepër penale serishme.¹⁵

Marrë në përgjithësi sanksionet penale paraqesin masa shtrënguese që zbatohen me dhunë dhe paraqesin represion ndaj kryerësit të veprës penale. Me anë të sanksioneve penale kryerësit të veprës penale i kufizohen apo i merren të drejtat, liritë dhe vlerat tjera shumë të rëndësishme, siç janë liria e lëvizjes, pasuria etj. Ndërsa, në disa vende ku akoma njihet si lloji i sanksionit dënimi me vdekje, kryerësit të veprës penale i merret edhe jeta. Së këndejmi, sanksionet penale, madje edhe ato ndër më të lehtat, në një masë janë një e keqe që e godasin personin që ka kryer vepër penale.¹⁶

¹³ Konventa për të Drejtat e Fëmijës (do të përdoret shkurtesa KDF) është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20.11.1989. Ky akt ndërkombëtar është i zbatueshëm drejtpërdrejt në Kosovë, sipas nenit 22

të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuar (do të përdoret shkurtesa APOKB) me datë 20 nëntor 1989, ndërsa ka hyr në fuqi në vitin 1991. Kjo Konventë kërkon në raste kur shqiptohet dënimi ndaj të miturve, duhet t'iu sigurohet trajtim human, kujdesi shëndetësor, arsimimi dhe ngritje profesionale; Udhëzimet për Parandalimin e Kriminalitetit të Rinjve (Udhëzimet e Riadit), janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 14.12.1990.

¹⁴ I marrë në: https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2346955, dt. 27-05-2018. Autori,: Öberg Jacob, The definition of criminal sanctions in the EU, European Criminal Law Review 3 (2013) 273, fq. 2-8.

¹⁵ Salihu, Ismet², E drejta Penale-pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2013, fq. 425-426.

¹⁶ Ibid, fq. 423.

2 Llojet e sanksioneve penale që shqiptohen ndaj te miturve

Në pajtim me trendët bashkëkohore në shkencën e së drejtës penale dhe në praktikën e gjyqësisë, pas çlirimit të Kosovës çështja e tretmanit të kryesve të mitur të veprave penale është heqë nga Kodi Penal dhe është rregulluar me ligj të posaçëm - me Ligjin Penal për të Mitur (do të përdoret shkurtesa LPM) i cili hyri në fuqi me 20 prill 2004. Më pas, me ndryshimet dhe plotësimet që hynë në fuqi me 8 korrik të vitit 2010, ky ligj tani emërtohet Kodi i Drejtësisë për të Mitur (do të përdoret shkurtesa KDM). Në Raport me Kodin Penal, Kodi i Drejtësisë për të Mitur është ligj special. Së këndejmi, ndaj kryesve të mitur të veprave penale dispozitat e Kodit Penal zbatohen vetëm për ato çështje të cilat nuk janë të rregulluara me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Sipas nenit 2 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, person i mitur konsiderohen ai person prej moshës 14-18 vjeçare. Në paragrafët e këtij neni është bërë ndarja e të miturve dhe atë: i mitur i ri konsiderohet personi ndërmjet moshës 14 dhe 16 vjet; i mitur i rritur personi ndërmjet moshës 16 dhe 18 vjet. Ndërsa madhor i ri konsiderohet personi ndërmjet moshës 18 dhe 21 vjet.¹⁷Në Kodin e drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës (do të përdoret shkurtesa RK) janë parapare disa lloje te masave edukative dhe masave të diversitetit. Përveç masave, janë përcaktuar edhe lloje te sanksioneve penale që mund t'i shqiptohen delinkuentëve të mitur, siç janë;

- dënimi me gjobë,
- urdhri për pune ne dobi te përgjithshme,
- burgimi për te mitur,
- dënimet plotësuese.¹⁸ dhe
- Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik

Elementet e sanksioneve penale ndaj të miturve janë:

- Sanksionet penale në përgjithësi dhe sanksionet penale ndaj të miturve në veçanti sajohen nga disa elemente themelore të tyre.

¹⁷ Salihu Ismet., Zhitija Hilmi., Hasani Fejzullah, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të botuar nga Organizata Gjermane GIZ, 2014, fq. 356.

¹⁸ *Shih*: Neni 7 të Kodit të Drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-193, të botuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës (do të përdoret shkurtesa G.Z.K), Prishtinë, Viti V, Nr. 78, të datës 20 gusht 2010.

- Sanksionet penale ndaj të miturve paraqesin vlerësim negativ moralo-etik ndaj veprës penale dhe kryerësit të mitur të saj. Si të tilla, janë në funksion të luftimit të kriminalitetit të të miturve dhe pengimit që në të ardhmen të kryejnë vepra penale.
- Sanksionet penale paraqesin një të keqe që e godet personin e mitur që ka kryer vepër penale. Kjo e keqe konsiston në marrjen dhe kufizimin e të mirave të caktuara juridike, siç janë: liria e lëvizjes, pasuria etj. Ky përbën një element retributiv të sanksioneve penale të të miturve.
- Sanksionet penale ndaj të miturve kanë qëllim të caktuar, i cili dëshirohet të arrihet me ekzekutimin e tyre. Qëllimi i përgjithshëm i sanksioneve penale ndaj të miturve, sikundër edhe i sanksioneve penale ndaj të rriturve është mbrojtja e shoqërisë dhe qytetarëve nga veprat penale përmes të cilave dëmtohen dhe rrezikohen vlerat më të rëndësishme të individit dhe shoqërisë.
- Sanksionet penale ndaj të miturve janë të përcaktuara me ligj. Ky në fakt është parimi i ligjshmërisë së sanksioneve penale ndaj të miturve sipas të cilit nuk mund të shqiptohet asnjë lloj sanksioni penal ndaj të miturve pa qenë ai paraprakisht i paraparë me ligj. Sipas këtij parimi të miturit mund t'i shqiptohet vetëm ai lloj i sanksionit penal, i cili është i paraparë me ligj për veprën penale konkrete. Parimi i ligjshmërisë paraqet garanci dhe mbrojtje të të miturve nga arbitrariteti eventual i organeve shtetërore. Cenimi i ligjshmërisë së sanksioneve penale ndaj të miturve nga ana e organeve shtetërore paraqet një rëndësi nga shkeljet më të rënda të ligjit dhe ndaj qytetarëve shkakton pasoja shumë të rënda, të cilat zakonisht janë të papërmirësueshme.
- Sanksionet penale mund t'u shqiptohen vetëm të miturve që kanë kryer vepra penale e që janë të përgjegjshëm. Përkatësisht sanksionet penale mund t'u shqiptohen vetëm atyre të miturve të cilët në kohën e kryerjes së veprës kanë qenë të përgjegjshëm dhe të fajshëm. Kjo nga fakti se vetëm i mituri penalisht i përgjegjshëm mund të përjetoj sanksionin penale si një të keqe e cila e godet atë për shkak të veprës së dëmshme që e ka kryer dhe vetëm ndaj të miturit të tillë sanksioni penal mund të ketë efekt që ai në të ardhmen të mos kryej vepra penale.¹⁹

¹⁹ Salihu.: fq. 184-186.

Sanksionet penale ndaj të miturve të parapara në Kodin e Drejtësisë për të Mitur të Republikës së Kosovës,²⁰ sikurse sanksionet penale për të mitur të shteteve tjera, i kanë disa cilësi të përbashkëta, të cilat ndryshe mund të përcaktohen si karakteristika të përgjithshme të sanksioneve penale për të mitur. Në fakt, sanksionet penale për të mitur si mjete kryesore dhe më të shpeshta të reagimit të shoqërisë ndaj kriminalitetit të të miturve, kanë disa karakteristika themelore. Si karakteristika të tilla konsiderohen:

- Me anë të sanksioneve penale të të miturve shoqëria mbron nga kriminaliteti i të miturve vlerat më të rëndësishme të njeriut dhe bashkësisë shoqërore. Këto sanksione janë dizajnuar për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njeriut, pronën e tij, rendin publik dhe vlerat tjera që vlerësohen të karakterit të përgjithshëm
- Sanksionet penale për të mitur mund t'u shqiptohen vetëm kryerësve të mitur të veprave penale. Kjo do të thotë se sanksionit penal për të mitur çdo herë duhet t'i paraprijë kryerja e veprës penale nga ana e të miturit. Së këndejmi, pa kryerje të veprës penale nuk mund të autorizohet shqiptimi i kurrfarë sanksioni penal ndaj të miturve. Ndaj të miturve mund të shqiptohet vetëm ai sanksion penal i cili është paraparë me ligj në momentin e kryerjes së veprës penale (nulla pena sine lege). Kjo veçori e sanksioneve penale për të mitur në brendinë e saj është sendërtim i parimit të ligjshmërisë dhe ka rëndësi të madhe për sigurinë juridike të qytetarëve, dhe duhet ta përjashtoj mundësinë që organet shtetërore, madje as gjyqet, kryerësit të mitur të veprës penale t'i shqiptojë ndonjë sanksion i cili nuk është i paraparë me ligj.
- Sanksionet penale për të mitur mund t'i shqiptoj vetëm gjykata, në rastin e masave të diversitetit edhe prokurori i shtetit, në bazë të procedurës së përcaktuar me ligj, e cila ofron më së shumti garanci për marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm. Rrjedhimisht, gjyqtarët për të mitur, si bartës të funksionit të gjykimit në kuadër të departamenteve për të mitur të gjykatave themelore dhe Gjykatës së Apelit, me arsimimin e tyre juridik, trajnimet dhe specializimet e arritura dhe përvojën e duhur që si rregull e kanë, janë më të kualifikuar për t'u shqiptuar sanksione penale kryerësve të mitur të veprave penale.
- Me anë të sanksioneve penale kryerësve të mitur të veprave penale u merren apo kufizohen disa nga liritë dhe të drejtat e tyre. Madje edhe sanksionet penale më të lehta,

²⁰ Gashi, Regjep¹, Ekzekutimi i Dënimeve Alternative, Prishtinë, 2013, fq. 15-18.

siç janë masat e diversitetit, në një mënyrë ose tjetër paraqesin një të keqe e cila e godet kryerësin e mitur të veprës penale.

- Sanksionet penale për të mitur janë mjete juridiko-penale të karakterit represiv, e të cilat ekzekutohen sipas detyrës zyrtare. Së këndejmi, ekzekutimi i këtyre sanksioneve penale nuk i është lënë vullnetit të të miturit ndaj të cilit ato janë shqiptuar, por kjo është detyrë që u atribuohet organeve të autorizuar të shtetit.
- Pluralizmi i sanksioneve penale. Në mesin e sanksioneve penale për të mitur ligjdhënësi kosovar ka paraparë masat e diversitetit, masat edukative, masat e trajtimit të detyrueshëm dhe dënimet (gjoba, urdhri për punë në dobi të përgjithshme, burgimi për të mitur dhe dënimet plotësuese). “Parashikimi i katalogut të gjerë të masave dhe dënimeve për të mitur është një domosdoshmëri e nevojshme, nga se në këtë mënyrë u mundësohet gjykatave që të përcaktohen për shqiptimin e llojit të caktuar të masës apo dënimit me të cilin më së miri do të arrihet qëllimi i edukimit, rehabilitimit dhe zhvillimit të drejtë të të miturit”.²¹

Masat edukative dhe masat e diversitetit janë masa kryesore të cilat u shqiptohen me se shpeshti kryerësve të mitur të veprave penale të cilat kanë karakter ndihmës dhe mbrojtës. Mirëpo është paraparë se me masa edukative dhe me masa të diversitetit nuk mund të luftohet kriminaliteti, sepse edhe të miturit kryejnë shpesh vepra të rënda penale, që për ato duhet t’ju caktohet trajtim afatgjatë dhe intensiv. Të gjitha këto masa dhe sanksione kanë për qëllim që të ndikojnë tek të miturit që të rehabilitohen dhe të integrohen si dhe të behet zhvillimi dhe trajtimi i drejtë i tyre në mënyrë që në të ardhmen t’i kthehen jetës normale dhe të bëhen pjesë vitale e shoqërisë. Këto sanksione penale u shqiptohen të miturve të cilët kanë kryer vepra penale në mënyrë që tek ata të ndikohet që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale të tilla, si dhe të ndikohet tek të miturit tjerë si një formë e kanosjes që edhe ata mos kryejnë vepra penale (qëllimi i sanksioneve penale tek të miturit trajton prevencion special dhe gjeneral).

2.1 Masat e diversitetit

Masat e diversitetit konsiderohen masa të lehta të cilat shqiptohen ndaj kryerësve të mitur në raste kur ata kryejnë ndonjë sjellje devijante ose kur vepra penale është e lehtë dhe nuk

²¹ Salihu², fq. 31-34.

paraqet rrezikshmëri të lartë dhe pasoja të rënda. Këto masa janë inkurporu edhe në traktate ndërkombëtare siç janë Rregullat e Tokios dhe Rregullat e Pekinit. Gjithashtu, këto masa parashihen edhe në të drejtën penale bashkëkohore.

Shkenca e së Drejtës penale por edhe Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës edhe sot e kësaj dite nuk e ka sqaru si duhet nocionin e masave të diversitetit. Ky mos përkufizim i qartë dhe i kuptueshëm është mungesë e evoluimit të doktrinës penale bashkëkohore por edhe të legjislacionit pozitiv bashkëkohor. Pra për përcaktimin e një përkufizimi të tillë duhen të merren në konsideratë elementet që kanë të bëjnë me figurën e veprës penale, rëndësinë, pasojat, motivin por gjithashtu duhet të merret parasysh edhe elementet e kryerësit të veprës penale si dhe qëllimi dhe efekti i shqiptimit të kësaj mase si në aspektin preventiv dhe rehabilitues. Në tërësi këto masa penale juridike janë të lehta dhe shqiptohen në raste kur i mituri kryen ndonjë sjellje delikuede të lehtë dhe qëllimi i shqiptimit të kësaj mase është parandalimi i fillimit të procedurës penale.

Sipas KDM-së, masat e diversitetit mund të shqiptohet ndaj të miturit i cili ka kryer veprë penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në tri (3) vite ose për veprë penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënim deri në pesë (5) vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen. Ndërsa për shqiptimin e kësaj mase është e domosdoshme të plotësohen kushtet e përcaktuara. Si kushte janë: pranimi i përgjegjësisë për veprën penale nga i mitur, shprehja e gatishmërisë nga i mituri që të pajtohet me palën e dëmtuar dhe pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit.²²

Sipas të drejtës pozitive të Kosovës llojet e masave të diversitetit që mund të shqiptohen kryerësit të mitur janë:

- pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar²³;
- pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;

²² KDM, neni 17, paragrafi 1, dhe 2.

²³ Shih: Aktvendimin PM. nr. 116/2014 të Gjykatës Themelore në Prizren. Përmes këtij aktvendimi, kjo gjykatë të miturit B.H. nga Prizreni ia ka shqiptuar masën e diversitetit Pajtim në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkimfaljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar, me ç'rast të dëmtuarin G. M. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

- kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit , të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;
- vijimi i rregullt në shkollë;
- pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij;
- kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë;
- edukimi në rregullat e trafikut; dhe
- këshillimi psikologjik.²⁴

Sipas nenit 83 të KDM-së, ekzekutimi i masave të diversitetit bëhet kur prokurori, gjyqtari për të mitur ose gjykata shqipton njëri nga masat e diversitetit, ndërsa aktvendimin dhe të gjitha informacionet i'a dërgon shërbimit sprovues kompetent për ekzekutim. Organi i cili ka shqiptuar këto masa, është përgjegjës dhe kompetent për ekzekutim. Nëse i mituri nuk i përmbahet obligimeve, shërbimi sprovues verifikon faktet dhe e informon organin i cili e ka shqiptuar dhe prokurorin kompetent.²⁵

Masat e diversitetit²⁶ janë shqiptuar më së shumti nga gjykatat në Kosovë. Kështu gjatë vitit 2010 janë shqiptua 243 masa, gjatë viti 2011 janë shqiptu 458 masa dhe gjatë viti 2012 janë shqiptu 317 masa.²⁷ Siç, po shihet ekziston një trend i rritjes së shqiptimit të këtyre masave. Kjo vjen edhe si rezultat i kërkuar nga shoqëria por edhe i strategjive dhe programeve të ndryshme politikes së luftimit të krimit.

²⁴ Ibid., neni 18, paragrafi 1.

²⁵ Halili, Ragip², Penologjia, Prishtinë, 2014, fq. 260.

²⁶ Sipas neni 12 të Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat, gjyqtari për të mitur është autoriteti që i gjykon çështjet penale për të mitur për të cilat është paraparë si dënim gjoba ose dënimi me burgim deri në 5 vjet, kurse trupi gjykues përbën autoritetin gjyqësor që gjykon veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim prej 5 vitesh e më shumë. Të dy këto autoritete veprojnë në kuadër të Departamentit për të Mitur të Gjykatës Themelore

²⁷ Shërbimi Sprovues i Kosovës (do të përdoret shkurtesa SHSK), Buletini, nr.8, 2013, fq. 16. Rregullat Standarde Minimale të OKB-së për trajtimin e të Burgosurve, Adptuar nga Kongresi I i Kombeve të Bashkuar për parandalimin e krimeve dhe trajtimin e delikuentëve, mbajtur në Gjenevë, m, më 1955 dhe miratuar nga Këshilli ekonomik e shoqëror me rezolutat e tij 663C (XXIV), datë 31 korrik 1957 dhe 2076 (LXII), datë 13 maj 1977. Konveta kundër torturës dhe dënimeve a trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, miratuar (do të përdoret shkurtesa KTDMD) dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën e saj 39/46 të 10 dhjetorit 1984. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, (do të përdoret shkurtesa DUDN) miratuar dhe shpalur nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën e saj 217 A(III) të datës 10 dhjetor 1948.

3 Masat Edukative

Kodi Penal për të Mitur i Republikës së Kosovës ka përcaktuar disa parime dhe rregulla orientuese mbi ekzekutimin e masave edukative ndaj të miturve. Këto parime janë paraparë në nenet 84-88. Sipas tyre gjykata e cila i ka shqiptuar masat e edukative është kompetente që ta mbikëqyrë edhe ekzekutimin e tyre. Shërbimi sprovues kompetent ku i mitur e ka vendbanimin e përhershëm apo të përkohshëm ka kompetenca për ushtrimin e përgjegjësive lidhur me ekzekutimin e masave edukative. Në vazhdim të parimeve themelore përmendet obligimi që gjatë ekzekutimit të masave edukative ndaj të miturve duhet të respektohet personaliteti dhe dinjteti i të miturve. Shërbimi sprovues ka për obligim që në mënyrë të veçantë të mbështesë inkurajimin e zhvillimit fizik, moral dhe intelektual duke mbrojtur shëndetin fizik dhe mendor të të miturit.²⁸

Qëllimi i masës edukative është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.²⁹

Masa edukative ekzekutohet duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e të miturve, duke inkurajuar zhvillimin e tyre fizik, moral dhe intelektual, si dhe duke mbrojtur shëndetin e tyre fizik dhe mendor.³⁰ Shpenzimet për ekzekutimin e masës edukative paguhet nga buxheti i Kosovës. Prindërit ose personat të cilët janë të obliguar me ligj të kujdesen për të miturin mund të obligohen që të kontribuojnë në pagimin e shpenzimeve për ekzekutimin e masës edukative.³¹ Masa edukative ekzekutohet pas vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe kur nuk ka më pengesa juridike për ekzekutimin e saj, përveç rasteve kur ky Kod parasheh ndryshe. Vendimin e formës së prerë gjykata ia dërgon institucionit të autorizuar apo individit për ekzekutim brenda tri (3) ditëve nga dita kur vendimi merr formë të prerë, së bashku me certifikatën e lindjes, dëftesën e shkollës ose dokumentin për transferim, raportin e kontrollit mjekësor, të dhënat nga dosja penale për vepra penale të mëhershme, procedurën e zbatuar dhe raportin e lëshuar nga shërbimi sprovues. Institucioni i autorizuar apo individit i cili e pranon vendimin për ekzekutim e

²⁸ Halili², fq. 260.

²⁹ KDM, neni 19.

³⁰ Ibid, neni 85.

³¹ Ibid, neni 86.

fillon ekzekutimin e dënimit brenda tre (3) ditëve nga pranimi i vendimit. Gjykata kompetente ruan të dhënat për çdo të mitur ndaj të cilit është shqiptuar masë edukative.³²

Masat edukative (do të përdoret shkurtesa ME) ndahet në tri grupet, ndërsa keto tri grupe ndahen në nëngrupe. Sipas dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, masat edukative janë: Masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat institucionale.

3.1 Masat Disiplinore.

Masat disiplinore ndaj personave të mitur, janë masat më të lehta edukuese-përmirësuese të cilat ndërmirren ndaj personave të mitur që kanë kryer sjellje të lehta delikvente. Zakonisht, këto masa ndërmirren dhe shqiptohen ndaj personave të mitur, të cilët për herë të parë kanë kryer ndonjë sjellje devijante dhe delikvente. Këto sjellje, më tepër janë rezultat i një mos kujdesi dhe neglizhence të vetë personave të mitur ose të rrethit të caktuar. Këtu nuk kemi të bëjmë me një personalitet i cili ka devijuar nga aspekti social dhe psikik por veprimi dhe sjellja kriminale është më tepër rezultat i disa rrethanave dhe situatave të rastit, prandaj konsiderohet se me masa të lehta mund të ndikohet që personi i tillë të përmirësohet dhe të heqë dorë nga sjelljet e tilla devijante apo delikvente. Në nenin 20, paragrafi 2 të KDM-së, ka parapa masat më të njohur disiplinore, e ato janë: qortimi dhe dërgimi në qendrat disiplinore.³³

Sipas nenit 22 paragrafi 1 dhe 2 i Kodit të drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës, gjykata e shqipton këtë masë kur konsideron se është e mjaftueshme dhe në dobi të të miturit duke ndikuar pozitivisht në sjelljet e tij. Masa edukuese sipas vendimit të gjykatës mund të zgjasë më së shumti një muaj me nga katër orë në ditë. Kjo masë mund të ekzekutohet gjatë festave shtetërore apo festave tjera shkollore më së shumti 4 ditë dhe atë deri në tetë orë në ditë.³⁴

Sipas viti 2014, Gjykatat kanë shqiptu 60 herë masën e qortimit gjyqësor dhe 18 herë masën e dërgimit në qendrën disiplinore.³⁵ Gjatë vitit 2015, gjykata kanë shqiptu 30 masa të qortimit gjyqësor dhe 19 të dërgimit në qendra disiplinore.³⁶ Ndërsa në vitin 2016, gjykata ka shqiptu 105 masa të qortimit gjyqësor dhe 14 masa të dërgimit në qendra disiplinore.³⁷

³² Ibid., neni 87.

³³ Halili², fq. 261-262.

³⁴ Ibid.,

³⁵ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2014", fq. 11.

³⁶ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2015", fq. 11.

³⁷ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2016", fq. 16.

Pra, siq po shihet, lirisht mund te konstatojmë se shqiptimi i masave disiplinore nga gjykata ka pasur një rritje të theksuar ndër vite. Gjithashtu, mund të japim një konkludim se qortimi gjyqësor është shqiptua disa herë më shumë se masa e dërgimit në qendrën disiplinore. Masa e dërgimit në qendrën disiplinore në praktikën gjyqësore shqiptohet më rrallë, për arsye se akoma nuk ekzistojnë institucione adekuat për ekzekutim. Zakonisht kjo masa ekzekutohet në shkolla dhe sipas legjislacionit pozitiv dhe Konventave ndërkombëtare nuk është interes që të pengohet vijimi i rregullt në shkollë të të miturit.

3.2 Masat edukative të mbikëqyrjes së shtuar

Në sistemin e masave edukative ndaj të miturve, që kanë karakter jashtë- institucional, janë edhe masat e mbikëqyrjes së shtuar, që gjithashtu aplikohen dhe zbatohen në praktikën gjyqësore të disa shteteve. Ekziston bindja se këto masa janë të përshtatshme për pengimin e disa veprimeve dhe sjelljeve delikuede të personave të mitur. pa aplikuar ndonjë masë të shtrëngimit dhe presionit.³⁸ Sipas Kodit të drejtësisë për të mitur i Kosovës, masat e mbikëqyrjes së shtuar janë: mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit, mbikëqyrja e shtuar në familjen tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi e kujdestarisë.

Ekzekutimi i masës edukative të mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit, fillon nga dita kur prindërve ose kujdestarit u dorëzohet vendimi i gjykatës për ekzekutimin e kësaj mase. Prindërit ose kujdestari kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes të përhershëm dhe të plotë edukimit të personit të mitur, t'i zbatojnë urdhëresat dhe udhëzimet e gjykatës dhe organeve të kujdestarisë, dhe të ndërmarrin masa që parandalojnë ndikimin e dëmshëm ndaj personit të mitur. Ndërsa masa e mbikëqyrjes së shtuar nga familja tjetër, gjykata vendos që personi i mitur dhe mbikëqyrja e tij t'i besohet familjes tjetër. Familja tjetër duhet t'i plotësojë disa kushte themelore, e në rend të parë të jetë një ambient i shëndoshë familjar dhe të ketë kushte për ofrimin e mbikëqyrjes dhe ndihmës ndaj personit të mitur. Shërbimi sprovues dhe familja të cilës i është besuar personi i mitur, lidhin një kontratë me shkrim. Në këtë kontratë përcaktohen obligimet që i merr përsipër familja ndaj të miturit si dhe kushtet dhe afati i qëndrimit të personit të mitur.³⁹

³⁸ Halili², fq. 263.

³⁹ Për më gjerësiht shih nenin 94, 95, dhe 96 të KDM-së. Shih Aktvendimin PM. nr. 115/2014 të Gjykatës Themelore në Prizren. Me këtë aktvendim, kjo gjykatë të miturit nga Prizreni ia ka shqiptuar masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit, me ç'rast atij ia ka caktuar këto detyrime: të përmbahet nga çfarëdo

Sipas të dhënave zyrtare, masat e mbikëqyrjes së shtuar janë shqiptua nga gjykata më së shumti në krahasim me masat e tjera. Sipas vitit 2014, në tërë territorin e Kosovës janë shqiptu gjithsej 523 masa të mbikëqyrjes së shtuar⁴⁰, ndërsa gjatë vitit 2015 janë shqiptu 350 masa të mbikëqyrjes së shtuar⁴¹ dhe në vitin 2016 janë shqiptu 397 masa të mbikëqyrjes së shtuar.⁴² Pra, nëse e analizojmë këto statistika del se në vitin 2014 gjykatat kanë shqiptu më së shumti masa në krahasim me vitet e tjera.

3.3 Masat edukative institucionale

Masat edukative institucionale përfshijnë vendosjen e delinkuentëve të mitur për një kohë relativisht më të gjatë në institucione dhe nënkuptojnë ndarjen e tyre nga ambienti i mëparmë familjar, social dhe shkollor. Zakonisht, masat institucionale aplikohen ndaj personave të mitur që kanë kryer sjellje dhe veprime kriminale të cila janë më të rrezikshme, e nga ana tjetër, personaliteti i tyre vërteton se duhet të ndërmerren disa metoda dhe mjete të posaçme të riedukimit dhe riintegrit. Vendosja e personave të mitur në ente dhe institucione të veçanta arsyetohet edhe me faktin se ambienti i deritanishëm ka pasur ndikim negativ dhe vlerësohet se është e domosdoshme që ata të largohen edhe në mënyrë fizike për një kohë të caktuar nga ai ambient, me qëllim të eliminimit të ndikimeve të tilla dhe krijimit të shprehive e vetive të reja konstruktive.⁴³

Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur të Republikës së Kosovës masat edukative ndahen në: dërgimi në institucionin edukativ, dërgimi në institucionin edukativ korrektues dhe dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm.

Dërgimi në institucionin edukative sipas Kodit të drejtësisë për të mitur i Kosovës, në nenin 27 parag, 2, ka paraparë kohëzgjatjen e kësaj mase e cila nuk mund të jetë më pak se 3 muaj dhe as më shumë se 2 vjet. Ekzekutimi i kësaj mase edukuese bëhet në institucione të veçanta edukative të cilat ndërtohen për këto qëllime ose në kuadër të institucioneve ekzistuese

kontakti me individ të caktuar që mund të kenë ndikim negativ ndaj të miturit, të pranojë të aftësohet në ndonjë profesion që i përshtatet shkathtësive dhe aftësive të tij, dhe personalisht t'i kërkoj falje palës së dëmtuar . të cilit me veprimet e tij të paligjshme i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor.

⁴⁰ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2014", fq. 11. Sipas këtyre të dhënave nuk klasifikohen masat e mbikëqyrjes së shtuar, por vetem jepen të dhëna lidhur me masën e mbikëqyrjes së shtuar. Kështu që masat e mbikëqyrjes së shtuar ndahen në tri grupe.

⁴¹ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2015", fq. 11.

⁴² Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2016", fq. 16.

⁴³ Për më gjerësi shih: Halili², fq. 266-270.

edukative, si në: konvikte, shtëpi të nxënësve dhe institucione të ngjashme ku edhe ashtu gjenden të mitur dhe të rinj të cilët qëndrojnë aty gjatë kohës së arsimimit dhe shkollimit të tyre. Ndërsa masa tjetër e dërgimit në institucionin edukativ korrektues⁴⁴ ekzekutohet në institucionin i cili është themeluar posaçërisht për këtë qëllim. Këto institucione ku ekzekutohet masa edukative-korrektuese mund të jenë të tipit të hapur, gjysmë të hapur dhe të mbyllur. KDM-së në nenin 113, paragraf, 1 konstaton se ky institucion është i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur. Për disa kategori të personave të mitur, themelohen edhe institucione të posaçme edukative-korrektuese. Institucioni edukativo-korrektues, personave të mitur u afron mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, me qëllim të edukimit, arsimimit dhe zhvillimit të tyre të mëtejme. Gjithashtu edhe masa e dërgimit në institucionin me kujdes të posaçëm u shqiptohet personave të mitur të cilët kanë kryer sjellje delikvente për shkak të çrregullimeve dhe ngecjeve në zhvillimin e tyre biopsikik dhe shpirtëror. Zakonisht, fjala është për persona të mitur delikuent që kanë disa të meta dhe defekte, si: personat shurdhmemec, personat e verbër, persona me zhvillim të vonuar psikik dhe personat e mitur me çrregullime tjera shpirtërore dhe mentale. Neni 123 i KDM-së konstaton se kjo masë shqiptohet të miturve me çrregullime mendore dhe hendikep fizik. Kjo masë ekzekutohet në institucionet e specializuara të cilat kanë kushte dhe mundësi që përveç edukimit të ofrojnë edhe tretman përkatës të karakterit mjekësor. Këto institucione zakonisht janë institucione të mbrojtjes sociale, të edukimit, të arsimit dhe të mbrojtjes shëndetësore. Gjykata e cila e ka shqiptuar këtë masë çdo gjashtë muaj e rishikon nevojën për qëndrim të mëtejme të të miturit në institucion. SHSK, është kompetent në bashkëpunim me policinë është i autorizuar të dërgojë të miturin në institucionin e kujdesit të posaçëm.⁴⁵

Sipas të dhënave zyrtare në tërë territorin e Kosovës gjatë vitit 2014 nga gjykata janë shqiptu 56 masa edukative institucionale⁴⁶, gjatë vitit 2015 janë shqiptu 15 masa edukative⁴⁷ dhe

⁴⁴ Inicialet e personave të mitur janë të ndryshme për arsye të konficiadilitetit. Shih Aktvendimin PM. nr. 18/2013 të Gjykatës Themelore në Prizren (GJTHP). Kjo gjykatë u ka shqiptuar të miturve R. B. dhe S.T. masën edukative të dërgimit të të miturit në institucionin edukativo korrektues në kohëzgjatje prej 3 vjetëve, kurse të dëmtuarën A.T. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil. Kjo masë është shqiptuar për shkak se të dy të miturit në bashkëveprim me njëri tjetrin kanë kryer tri vepra penale të vjedhjes së rëndë (vjedhje të stolive të arit në shumë prej 6300 Euro). Në këtë rast gjykata ka konstatuar se tek të miturit ka çrregullime të larta të nivelit të edukimit, ashtu që riedukimi i tyre është i mundur vetëm përmes vendosjes së tyre në një institucion të karakterit korrektues, dhe me një përkujdesje e mbikëqyrje të një stafi të specializuar.

⁴⁵ Halili², fq. 270.

⁴⁶ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2014", fq. 11.

⁴⁷ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2015", fq. 11.

ë vitin 2016 janë shqiptu 46 masa edukative institucionale.⁴⁸ Siç po shihet del se në vitin 2014 janë shqiptua më së shumti masa edukative se në krahasim me vitet paraprake por shihet një rritje e vogël gjatë viteve të fundit.

4 Dënimi me gjobë

Si një nder llojet e dënimeve për te mitur, dënimi me gjobe është shfaqur me herët, por ka filluar te masivizohet pas vitit 1980.⁴⁹ Dënimi me gjobe bene pjese ne llojet e dënimeve me karakter pasurore. Me ane te këtij dënimi, kryesi i veprës penale detyrohet qe brenda afatit te caktuar te paguaje një shume te hollash ne dobi te shtetit.⁵⁰ Ky lloj dënimi mund t'ju shqiptohet vetëm te miturve te rritur⁵¹. Gjykata mund te shqiptoj dënimin me gjobe ndaj te miturit nëse i mituri ka mjete për ta paguar gjobën,⁵² e në raste i mitur nuk ka mjete financiare, atëherë gjykata nuk mundet të shqiptoj dënimin me gjobë. Lartësia e dënimit me gjobë për të miturit, varet nga gjendja e tyre financiare, nga lartësia e të ardhurave personale, të ardhurave të tjera, pasuria e tyre dhe obligimet që kanë. Të miturit nuk mund t'i shqiptohet denimi me gjobë më i lartë se mjetet që ai posedon. Me rastin e shqiptimit te dënimit me gjobe, gjykata shqyrton gjendjen financiare të të miturit dhe ne veçanti lartësinë e te ardhurave te tij personale, te ardhurat te tjera, pasurinë dhe detyrimet.⁵³ Caktimi dënimit me gjobe zbatohet ashtu sikur te personat madhore, mirëpo ndryshon minimumi dhe maksimumi i këtij dënimi. Sipas KDM-së për te mitur minimumi i dënimit me gjobe për te mitur është 25 euro, ndersa maksimumi 5000 euro. Me aktgjykim përcaktohet afati për pagesën e gjobës i cili nuk mund te jete me i shkurtër se pesëmbëdhjete (15) dite e as me i gjate se tre (3) muaj, por ne rrethana te arsyeshme gjykata mund te lejoje pagesën e gjobës jo me gjate se dy (2) vjet. Me Kodin e drejtësisë për te mitur është parapare se ndaj te miturit mund te zëvendësohet dënimi me gjobe me urdhër për pune ne dobi te përgjithshme, ne qofte se i mituri nuk jep pëlqimin për pagesën e gjobës apo nuk

⁴⁸ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2016", fq. 16.

⁴⁹ Salihu¹, fq. 68.

⁵⁰ Salihu², fq. 455.

⁵¹ KDM., sipas nenit 2, parag, 1, nënparagrafi 1.4, me nocionin i "mitur i rritur", kuptohet personin ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.

⁵² Ibid., neni 30, parag, 1.

⁵³ Ibid.,

mundet te paguaje atë.⁵⁴ Gjoha e shqiptuar ndaj te miturit e cila nuk është paguar nuk mund te zëvendësohet me burgim. Por me ndryshimin e Ligjit penal për të mitur edhe kjo çështje është rregulluar në mënyrë eksplicite. Kështu, Gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë me ndonjë masë edukative jo institucionale, nëse i mituri nuk e paguan dënimin me gjobë, e as nuk pajtohet me zëvendësimin e saj me urdhrin me punë në dobi të përgjithshme.⁵⁵

Nëse i analizojmë Statistikat e Jurisprudencës të Kosovës (do të përdoret shkurtesa SJK) për shqiptimin e dënimit me gjobë gjatë periudhës së vitit 2016, lirisht mund të theksojmë se në të gjitha gjykatat themelore të Kosovës, dënimi me gjobë shqiptohet në numër të vogël ose fare hiq. Kështu, gjatë periudhës 2016, janë shqiptuar vetëm 6 dënime me gjobë dhe 2 dënime me gjobë i ka shqiptuar Gjykata themelore në Gjilan dhe 4 dënime me gjobë i ka shqiptuar Gjykata themelore në Prishtinë, ndërsa Gjykatat e tjera fare nuk kanë shqiptua dënim me gjobë.⁵⁶ Ndërsa në vitin 2015 në tërë territorin e Kosovës janë shqiptua 2 dënime me gjobë,⁵⁷ dhe gjatë vitit 2014 janë shqiptu 3 dënime me gjobë.⁵⁸ Nëse i analizojmë këto tri vite vërejmë se viti 2016 ka pas një rritje solide të shqiptimit të dënimit me gjobë në krahasim me vitet paraprake. Ky mos shqiptim i dënimit me gjobë ose në numër të vogël, është si rezultat i arsyeve të lartcekurave, kur i mitur nuk mjete financiare ose nuk pajtohet apo në raste kur prindërit nuk e japin pëlqimin për ekzekutim të dënimit. Pra edhe nëse i krahasojmë me vitet paraprak këto të dhëna janë të njëjta pothuajse, ose mund të ketë variacione të vogla.

⁵⁴ KDM, neni 30, paragrafi 2, 3 dhe 4. Shih Aktgjykimin PM. nr. 256/2013 të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Me këtë aktgjykim kjo gjykatë e ka obliguar të miturin R.H. nga Prishtina që të paguaj shumën prej 1.300 Euro në afat prej 15 ditësh në buxhetin shtetëror

⁵⁵ Ibid, paragrafi 5. Është shumë me rëndësi të analizohet një Mendim Juridik i Gjykatës Supreme, ku parashtrahet pyetje për mënyrën e pagesës së dënimit me gjobë. Sipas këtij mendimi juridik, në raste kur është shqiptuar dënim me gjobë së bashku me dënimin me burgim atëherë vlejné dispozitat e nenit 46 të KPK-së, por gjykata në raste kur i dënuar nuk e paguan gjobën i ka disa alternativa të mundshme të veprimit dhe do të zbatojë atë alternativë të caktuar me aktgjykim, shiko nenin 46, paragrafi 2, 3, 4 dhe 5 të KPK-së. Në çdo rast te persona madhor, gjykata është e obliguar të caktojë ne dispozitiv mënyrën e ekzekutimit të dënimit me gjobë, në raste kur i pandehuri nuk dëshiron të paguaj gjobën ose nuk ka mundesi të paguaj. Në raste kur gjykata ka shqiptuar dënime alternative, ku parashihen dënimi me gjobë dhe me burgim, si për veprat penale në bashkim, atëherë gjykata nuk mund të aplikojë dispozitat e nenit 80, paragrafi 2 dhe nënparagrafi 2.2 i KPK-së për shqiptimin e dënimit unik. Këtë mendim juridik e ka dhënë Gjykata Supreme në pyetjen e parashtruar nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Ky vendim juridik nuk specifikohet e vlenë edhe për personat e mitur, por nëse i referohem dispozitave të KPK-së dhe KDM, atëherë lirshëm mund te theksojmë, se ky mendim juridik nuk vlen për mënyrën ekzekutimit të dënimit me gjobë ndaj të miturve, sepse në mënyrë eksplicite e kanë trajtu dispozitat e KDM-së. Për më gjerësisht shih: Mendimin Juridik, Agj.nr. 2016/2015, të datës 10.07.2015, Gjykata Supreme e Kosovës, Prishtinë.

⁵⁶ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2016", fq. 16.

⁵⁷ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2015", fq. 11.

⁵⁸ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2014", fq. 11.

5 Dënim me urdhër për pune në dobi të përgjithshme

Urdhri për pune ne dobi te përgjithshme është lloj i dënimit i cili është paraqitur me vone ne krahasim me dënimin me gjobe. Ky lloj dënimi është substitute i dënimit me gjobe apo dënimit me burgim, keshtu qe kryesit te veprës penale ne vend qe t'i shqiptohet dënimi me gjobe apo dënimi me burgim, i caktohet një detyrim qe brenda afatit te caktuar te kryeje një pune ne interes te përgjithshëm pa pagese. Me pajtimin e te miturit, gjykata mund ta zëvendësoje masën edukative deri ne tri vjet, burgimin e te miturit deri ne dy vjet ose gjobën me urdhër për pune ne dobi te përgjithshme.⁵⁹

Ne Kosove urdhri për pune ne dobi te përgjithshme ka filluar te ekzekutohet pas luftës ne Kosovë, ku ka pasur një sukses te mirë deri me sot.⁶⁰ Për te mundur gjykata te shqiptoje dënimin me pune ne dobi te përgjithshme për te mitur, sipas Kodit të drejtësisë për te mitur duhet te plotësohen këto kushte:

- kryesi i veprës penale duhet te jete i mitur,
- duhet te konstatohet se ne kohen e kryerjes se veprës penale i mituri ka qene penalisht përgjegjës,
- duhet qe për veprën penale te kryer gjykata te miturit t'i ketë caktuar masën edukative institucionale, burgimin për te mitur apo dënimin me gjobe, dhe
- qe i mituri te japë pëlqimin, te dakordohet qe masa edukative institucionale, burgimi për te mitur apo dënimi me gjobe t'i zëvendësohet me dënimin me pune ne dobi te përgjithshme. Se këndejmi, gjykata nuk mund te zëvendësoje dënimin me pune ne dobi te përgjithshme me dënimet e cekura apo masat edukative institucionale, nëse i mituri paraprakisht nuk pajtohet.⁶¹

Kur gjykata e shqipton urdhrin për pune ne dobi te përgjithshme, gjykata e urdhëron te miturin qe te kryeje pune ne dobi te përgjithshme pa pagese për një afat te caktuar prej tridhjetë (30) deri njëqind e njëzet (120) orëve. Shërbimi sprovues⁶² përcakton llojin e punës ne dobi te përgjithshme te cilën duhet ta kryeje personi, cakton organizatën specifike për te cilën personi i

⁵⁹ KDM, neni 31, parag. 1.

⁶⁰ Salihu¹, fq. 71.

⁶¹ Ibid., fq. 72.

⁶² Për më gjerësisht lidhur me Shërbimin Sprovues, shih: Halili, Ragip², Penologjia, Prishtinë, 2014, fq. 200-201. Shërbimi Sprovues është një organ i cili ka për detyrë të kyçet në ekzekutimin e dënimeve alternative dhe riintegrimin shoqëror të personave të dënuar, gjithashtu, është kompetent për të ndihmuar në ekzekutimin e masave educative ndaj të miturve si atyre jashtë institucionale ashtu edhe intitucionale.

dënuar do ta kryej punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës kur do të kryhet puna dhe mbikëqyre kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.⁶³ Gjykatës e cila e ka shqiptuar dënimin për punë në dobi të përgjithshme, zyrtaret e shërbimit sprovues i dorëzojnë raport me shkrim dhe e njoftojnë për çfarëdo në ekzekutimin e kësaj mase. Mirëpo puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet brenda periudhës së caktuar nga gjykata, e cila nuk zgjat më shumë se një vit.⁶⁴

Urdhri për punë në dobi të përgjithshme të miturit nuk guxon që ta pengoj në vijimin e rregullt në shkolle apo në aktivitete të tjera. Ekzekutimi i urdhrit për punë në dobi të përgjithshme është shumë më i përshtatshëm për riedukimin e të miturve se sa masat institucionale, apo dënimi me burgim, sepse i mituri mund të fitojë shprehë për punë, si dhe nuk i ekspozohet masave represive të dënimit me burgim. Po ashtu dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme është edhe në interes të shoqërisë, sepse kryhen disa punë dhe kursehen shpenzimet e mbajtjen në burgim.

Sipas statistikave zyrtare të Kosovës për vitin 2016, dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme⁶⁵ është shqiptuar në tërë territorin e Kosovës 51 herë. Kështu gjykata themelore në Prizren ka shqiptuar 15 dënime me urdhër për punë në dobi të përgjithshëm, gjykata themelore në Pejë ka shqiptuar 1 dënim me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata themelore në Prishtinë ka shqiptuar 11 dënime me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata themelore në Ferizaj ka shqiptuar 17 dënime me urdhër për punë në dobi të përgjithshme dhe gjykata themelore në Mitrovicë ka shqiptuar 7 dënime me urdhër në dobi të përgjithshme.⁶⁶ Ndërsa gjatë vitit 2015 janë shqiptuar 69 dënime me urdhër për punë në dobi të përgjithshme,⁶⁷ dhe gjatë viti 2014 janë shqiptuar 64 dënime me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.⁶⁸ Shikuar këto të dhëna, vërejmë se vitit 2015 ka pas një rritje të vogël në krahasim me vitet e tjera. Po ashtu vlen

⁶³ KDM, neni, 31, parag. 2.

⁶⁴ Ibid., parag. 3.

⁶⁵ Shih Aktgjykimin PM. nr. 313/2011 të Gjykatës Themelore të Pejës. Me këtë aktgjykim, kjo gjykatë ia ka shqiptuar të miturit Sh.K. nga Peja, me ç'rast e ka detyruar atë që të kryej punë në dobi të përgjithshme pa pagesë në kohëzgjatje prej 100 orëve në Qendrën Rajonale për Aftësi Profesionale në Pejë. Krahas punës pa pagesë e cila ka konsistuar në rregullim të ambientit të jashtëm dhe të brendshëm të këtij institucioni, ai ka ndjekur edhe kursin për saldues, ku edhe ka marrë edhe certifikatën përkatëse të aftësimin profesional. (308) Punët të cilat kryerësi i mitur i veprës penale detyrohet t'i kryej mund të jenë p.sh., të pastrojë rrugët, parqet e qytetit, të kujdeset për persona të moshuar apo të sëmurë, të punojë në ndonjë shoqatë humanitare.

⁶⁶ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2016", fq. 16.

⁶⁷ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2015", fq. 11.

⁶⁸ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2014", fq. 11. Për më gjerë lidhur me këto të dhëna shiko Agjencionin e Statistikave të Kosovës dhe periudhen vjetore 2014, 2015, 2016. Shiko linkun: <http://ask.rks-gov.net/>

të theksohet, se Gjykata themelore e Ferizajt ka shqiptua dënime me urdhër për punë në dobi të përgjithshme më shumë se Gjykatat e tjera themelore.

6 Dënimi me Kusht

Kodi i ri penal dhe Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale i Kosovës (do të përdoret shkurtesa LESP⁶⁹) kanë paraparë edhe dënimet alternative dhe kanë rregulluar ekzekutimin e tyre. Sipas nenit 50 të Kodit Penal⁷⁰ të Kosovës (në tekst do të përdoret shkurtesa KPK-së) qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit dhe as më e gjatë se pesë (5) vjet.⁷¹ Për të shqiptuar dënimin me kusht së pari duhet të plotësohen disa kushte;

- Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet,
- Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit,
- Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit nëse gjykata shqipton dënimin me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet, qoftë për një vepër penale ose për disa vepra në bashkim,
- Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale,

⁶⁹ Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-149, G.Z.K, 31/2013, të publikuar me datë, 28.08.2013 dhe Ligji Nr. 05/L-129 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit me Nr. 04/L-149, të publikuar në G.Z.K, datë 11.05.2017.

⁷⁰ Kodi Penal I Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-082, të publikuar në G.Z.K, Nr. 19/2012.

⁷¹ Ibid., neni 51, parag. 1.

- Kur gjykata shqipton dënimin me burgim ose dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim.⁷²

Sipas dispozitave të së drejtës penale ekziston edhe mundësia e revokimit të dënimit me kusht: Sipas nenin 53 të KPK-së, Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet, nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim me më pak se dy (2) vjet ose dënimi me gjobë, nëse dënimi me kusht është kushtëzuar me përmbushjen e një apo më shumë kushteve të paraparë dhe personi i dënuar nuk përmbush kushtin apo kushtet brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata mund ta vazhdojë afatin e përmbushjes së kushtit brenda afatit të verifikimit apo mund ta revokojë dënimin me kusht dhe ta ekzekutojë dënimin i cili është caktuar me dënimin me kusht. Nëse gjykata konstaton se personi i dënuar nuk ka mund ta përmbushë kushtin për shkaqe të arsyeshme, gjykata e heq përmbushjen e atij kushti ose e zëvendëson atë me një kusht tjetër përkatës të paraparë me ligj. Dënimi me kusht mund të revokohet gjatë kohës së verifikimit. Nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe kryen vepër penale për të cilën kërkohet revokimi i dënimit me kusht gjatë kohës së verifikimit, mirëpo kjo është konstatuar me aktgjykim të plotfuqishëm vetëm pas skadimit të kohës së verifikimit, dënimi me kusht mund të revokohet jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i kohës së verifikimit.⁷³ Lidhur me shqiptimin e dënimit me kusht ndaj të miturve zbatohen dispozitat e KPK-së vetëm nëse KDM parasheh ndryshe.

Ekzekutimi i dënimeve alternative fillon pasi vendimi i gjykatës të ketë marrë formën e prerë. Zakonisht gjykatë kompetente për ekzekutimin e këtyre dënimeve është gjykata ku e ka vendbanimin personi i dënuar me këto dënime. Nëse personi i dënuar me këtë dënim gjendet në paraburgim gjykata ia dërgon vendimin edhe institucionit të paraburgimit. Drejtori i institucionit të paraburgimit duhet ta liroj personin e dënuar në mënyrë që Shërbimit Sprovues t'i mundësohet ekzekutimi i këtij dënimi alternativ . Nëse gjykata e ka shqiptuar dënimin me kusht me të cilin njëherit urdhëron të dënuarin që të përmbush ndonjë obligim, Shërbimi Sprovues e

⁷² Ibid, neni 52.

⁷³ Ibid., neni 53, 54, 55,56.

mbikëqyr përmbushjen dhe e informon gjykatën për këtë: në mënyrë që ajo të ndërmerr vendime adekuate në këtë drejtim.⁷⁴

Sipas të dhënave nga Shërbimi Sprovues del se gjatë vitit 2010 janë ekzekutuar 209 dënime me kusht, gjatë vitit 2011 janë ekzekutuar 29 dënime me kusht dhe gjatë viti 2012 janë ekzekutuar 27 dënime me kusht.⁷⁵ Në i analizojmë këto të dhëna del qart se gjatë viteve të fundit ka pësuar një rënie e theksuar e shqiptimit të dënimit me kusht ndaj të miturve nga Gjykatat.

7 Dënimet Plotësuese

Dënimet plotësuese, siç dihet paraqesin një lloj të veçantë të sanksioneve penale në sistemin bashkëkohor penitenisar. Në penologjinë moderne, këtyre dënimeve u kushtohet kujdes i veçantë. Karakteri i këtyre dënimeve, në rend të parë, është i përcaktuar me rolin preventiv dhe parandalues në luftimin e kriminalitetit. Në trajtimet juridike-penale, kriminologjike dhe penologjike, këto dënime zënë vend të posaçëm. Ekziston bindja e bazuar se përsosja dhe zgjerimi i dënimeve plotësuese, do të ndikonte dukshëm në pengimin e disa formave të kriminalitetit në botën bashkëkohore. Në këtë drejtim, veçmas theksohet karakteri i tyre preventiv dhe mbrojtës.⁷⁶

Kodi penal i Kosovës ka paraparë këto dënime plotësuese:

- Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur,
- Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit,
- Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik,
- Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- Ndalimi i drejtimit të automjetit,
- Marrja e lejes së vozitjes,
- Konfiskimi,
- Urdhri për publikimin e aktgjykimeve dhe

⁷⁴ Halili², fq. 231-232.

⁷⁵ Shërbimi Sprovues I Kosovës, Buletini, nr. 8, fq. 16. Këto të dhëna janë vetem fragmentare, për arsye se gjatë hulumtimit në faqe të institucioneve nuk ekziston asnje buletin apo raport i vitit 2017.

⁷⁶ Halili², fq. 235.

– Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës.⁷⁷

Sipas neni 39 të KDM, kur gjykata e konsideron të arsyeshëm mund të shqiptoj dënime plotësuese ndaj të miturve në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës.

⁷⁷ KPK-së, neni 62. Këto dënime plotësuese janë përcaktuar në dispozita të kodit penale të Kosovës për persona madhor. Por sipas të drejtës tonë pozitive gjykata mund të shipton ndaj te mitur disa dënime plotësuese në përputhje me Kodin Penal nëse nuk parasheh ndryshe Kodi i Drejtësisë për të mitur.

1 Ekzekutimi i dënimit me burgim ndaj të miturve

Dënimi me burgim sot në sistemin e drejtësisë bashkëkohore konsiderohet si lloji më i rëndë i sanksioneve penale që shqiptohet ndaj të miturve. Ky dënim konsiston në marrjen e lirisë së lëvizjes (lirisë së qarkullimit) ndaj kryesit të veprës penale për një kohë të caktuar. Ky lloj dënimi konsiderohet një ndër dënimet më të rënda, ngase me këtë dënim kryesit të veprës penale i merret një e drejtë themelore ç'fare është e drejta e lëvizjes, qarkullimit të lirë.⁷⁸

Gjate shqiptimit të dënimit me burgim duhet pasur parasysh se i mituri nuk mund të vlerësoj rëndësinë e veprës penale sikur madhoret. Duhet pasur parasysh se puberteti dhe adoleshenca janë faza shumë të vështira për të miturin dhe mund të ndikoj drejtpërdrejtë në kriminalitet dhe ai nuk është i pjekur sa duhet psikikisht dhe shumë lehtë bie pre e ngacmimeve dhe provokimeve të ndryshme dhe si pasoje e kësaj mund të bëjë sjellje të pamatura dhe të bie në kundërshtim me rrethin ku jeton. Sipas këtyre që i cekem më lartë, gjykata gjate shqiptimit të dënimit me burgim duhet pasur parasysh se personat e mitur nuk duhet trajtuar ashtu sikur personat madhore.⁷⁹

Lufta kundër delikuencës së të miturve, nuk mund të udhëhiqet si mëse të njëjtë dhe me mjete të njëjta, sikurse edhe ndaj kryerësve të rritur të veprave penale si dhe llojet e sanksioneve nuk mund të shqiptohen njësoj sikurse ndaj të rriturve.

Qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin dhe riedukimin e të miturit dhe aftësimin e tij profesional. Po ashtu ky dënim duhet të ndikoj pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin.⁸⁰

Për t'u shqiptuar dënimi me burgim personit të mitur, duhet të plotësohen disa kushte kryesore si:

- Burgimi për të mitur mund t'i shqiptohet vetëm personit të mitur të rritur, të mitur i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka mbushur moshën 16 vjet, por nuk i ka mbushur moshën 18 vjet,

⁷⁸ Salihu², fq. 452-453.

⁷⁹ Zejneli², fq. 141-144.

⁸⁰ Halili², fq. 271.

- Burgim për të mitur mund t'i shqiptohet vetëm personit të mitur nëse ka kryer veprën penale për të cilën është parapa dënimi me burgim së paku 5 vite,
- Nëse gjykata konstaton nivelin e caktuar të përgjegjësisë, përkatësisht nëse është penalisht përgjegjës, dhe
- Burgimi për të mitur mund t'i shqiptohet nëse vepra penale ka shkaktuar pasoja të rënda dhe si rezultat nuk do të ishte adekuate shqiptimi i masës edukative.⁸¹

Kohëzgjatja e burgimit për të mitur nuk mund ta kalojë maksimumin e burgimit të paraparë për veprën penale por mund të jetë më i ulët se minimumi i burgimit të paraparë për veprën penale. Burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se gjashtë (6) muaj as më shumë se pesë (5) vjet dhe shqiptohet në muaj dhe vite të plota. Maksimumi i burgimit për të mitur është dhjetë (10) vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim afatgjatë, ose kur i mituri ka kryer së paku dy (2) vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë (10) vjet. Çdo herë kur gjykata trajton shqiptimin e dënimit me burgim për të mitur merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe renduese.⁸²

Lidhur me shqiptimin dhe ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj të miturve shqiptohet rëndom ndaj kategorisë së të miturve që kanë mbushur moshën 16-18 vjet. Mirëpo ky dënim në disa vende të botës shqiptohet dhe ekzekutohet edhe ndaj të miturve të ri prej moshës 13-16 vjet, kjo varet shumë nga rregullimi i sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror i shtetit.⁸³

Gjithmonë, dënimi me burgim ka karakter subsidiar dhe aplikimi i tij është fakultativ edhe pse përmbushen kushtet e lartpërmendura, gjykata varësisht prej vlerësimit të lirë të provave nuk është e obliguar gjithmonë të shqiptoj dënimin me burgim, por në shqiptimin e tij gjithmonë merr parasysh interesin e të miturit.

Sipas të dhënave del se gjatë vitit 2014 janë dënuar me burgim për të mitur gjithsej 94 persona të mitur⁸⁴, ndërsa gjatë vitit 2015 janë dënuar me burgim për të mitur gjithsej 76

⁸¹ Salihu¹, fq. 74.

⁸² KDM, neni 34.

⁸³ Halili², fq. 271. Shih: Halili², Disa organizata ndër-kombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve kanë publikuar gjatë vitit 2005 disa të dhëna shokuese mbi faktin se në 42 shtete federale të SHBA-së ekzistojnë dispozita ligjore që lejojnë shqiptimin dhe ekzekutimin e dënimit me burgim afatgjatë bile edhe me burgim të përjetshëm ndaj fëmijëve prej moshës 13-18 vjeçar. Sipas këtyre raporteve fëmijët e dënuar me burgim të përjetshëm nuk kanë të drejtë në falje apo amnesti. Të paktën 2225 fëmijë e vuajnë këtë dënim në SHBA për krimet që i kanë kryer kur ishin më të rinj se 18 vjet

⁸⁴ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2014", fq. 11

personat të mitur⁸⁵ dhe në vitin 2016 janë dënuar me dënim me burgim për të mitur gjithsej 63 persona të mitur.⁸⁶ Sipas këtyre të dhënave të ASK-së, del se gjatë viteve të fundit ka pas një rënie të theksuar të shqiptimit të dënimit me burim për të mitur. Kjo është edhe një indikator i fuqishëm se personat e mitur nuk janë të prirë të kryejnë krime të rënda, por mund të jete edhe një orientim i gjykatave që sa më shumë të shqiptohen masat edukative.

⁸⁵ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2015", fq. 11

⁸⁶ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, "Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2016", fq. 16 Sipas vitit 2014, 2015, 2016, del se nacionalitetit më së shumti që merr pjesë në kryerjen e kriminalitetit të mitur është nacionalitetit shqiptar, serb dhe turq. Kuptohet se nacionaliteti shqiptar është më i theksuar sepse territorin e Kosovës më shumë se 95% e popullsisë është Shqiptar. Ndërsa gjinia më e pranishëm është gjinia mashkullore se sa gjinia femërore. Krimet më së shpeshti që kryehen janë veprat penale kundër pasurisë, veprat penale kundër jetës dhe trupit etj.

2 Qëllimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të miturve

Ekzekutimi i burgimit për të mitur ka disa ngjashmëri por ka edhe disa dallime në krahasim me ekzekutimin e dënimit ndaj madhoreve. Zakonisht trajnimi ndaj të miturve të cilët dënohen, gjatë ekzekutimit të këtij dënimi përcillet me masa të përmirësimit, edukimit, riedukimit, angazhimit në punë, aktiviteteve të ndryshme muzikore, sportive gjithnjë duke pasur parasysh ndihmën ndaj të miturve, aftësimin e tyre në punë profesionale dhe riedukimin e suksesshëm të tyre. Gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit të miturve u ofrohet aftësim i duhur profesional, i bazuar në njohuritë e tyre, interesimin e tyre për aktivitete të ndryshme etj.⁸⁷

Burgimi për të miturit mbahet në institucion korrektues për të mitur dhe, në raste të jashtëzakonshme, në pavijone të ndara të institucionit korrektues për persona madhorë. Institucioni korrektues për të mitur është i llojit gjysmë të hapur dhe të hapur. Përjashtimisht të miturit mund të mbajnë dënimin me burgim për të mitur në institucionin korrektues të tipit të mbyllur. Të miturit të cilët bëhen madhor gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim të të miturit duhet të vendosen në pavijone të ndara të institucionit. Të miturit e mbajnë dënimin e tyre me burgim në institucionin korrektues për të mitur derisa të mbushin moshën njëzetetë (23) vjet. Nëse deri në këtë moshë ata nuk e kanë mbajtur dënimin e plotë, ata transferohen në institucionin korrektues për të rritur. Në raste të veçanta, personave të dënuar të cilët kanë mbushur njëzetetë (23) vjet mund t'u lejohet qëndrimi në institucionin korrektues për të mitur nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e përgatitjes ose aftësimin profesional të tyre, apo nëse pjesa e mbetur e dënimit të tyre që duhet mbajtur nuk është më e gjatë se gjashtë (6) muaj. Ata në asnjë mënyrë nuk mund të qëndrojnë në institucionin korrektues për të mitur pasi të kenë mbushur njëzeteshtatë (27) vjet.⁸⁸

Si rregull, të miturit i vuajnë dënimet e tyre së bashku. Me kërkesë të të miturit, drejtori i qendrës korrektuese mund të lejoj që i mituri të ndahet nga personat tjerë të dënuar, nëse drejtori çmon se shqetësimet e cekura në kërkesën e të miturit janë të arsyeshme dhe se nuk ka mundësi tjera për trajtimin e shqetësimeve të të miturit. Drejtori i qendrës korrektuese mund t'i

⁸⁷ *Shih*: Pjesën e katërt të Rregullave të Pekinit, të miratuar nga Asambleja e përgjithsme e Kombeve të bashkuar më 29 nëntor të vitit 1985, me Rezolutën nr. 40/33 dhe njihen me emrin Tërsia e Rregullave minimale të KB në lidhje me dhënien e drejtësisë për të mitur,.

⁸⁸ KDM, neni 136.

urdhëroj të miturit që të ndahet nga personat tjerë të dënuar, pa kërkesën e të miturit për ndarje të tillë, vetëm nëse masa e tillë është e nevojshme:

- Për të parandaluar rrezikun për jetë apo shëndet të të miturit a personave të tjerë; ose
- Për të parandaluar kërcënimin ndaj sigurisë së institucionit korrektues të shkaktuar nga prania e vazhdueshme e të miturit brenda përbrenda gjithë njerëzve të burgut.⁸⁹

Pushimi zgjat deri në tridhjetë (30) ditë dhe sipas rregullit ai lejohet atëherë kur nuk mbahen mësimet. I mituri ka të drejtë të kalojë të paktën tri (3) orë gjatë ditës në ambient të hapur brenda institucionit. I mituri nuk i nënshtrohet vetmisë si dënim disiplinor.⁹⁰

Ne Qendrën Korrektuese ne Lipjan (QKL) ekzistojnë dy qendra për aftësim profesional;

- Brenda perimetrit te qendrës ku ushtrohen këto veprimtari; hidroinstalues dhe murator, si dhe furrtari e cila gjendet brenda qendrës korrektuese, ku te miturit kryejnë kurs te veçantë për përgatitjen e bukës. Nga kjo furrtari, qendra korrektuese furnizohet me buke,
- Jashtë perimetrit te qendrës te miturit kane mundësi te zhvillojnë këto veprimtari si: kamerier, shankist, kuzhinier si dhe te gjitha gatimet e brumërave. Këto veprimtari ata kane mundësi qe ti ushtrojnë ne restorantet e caktuara nga qendra korrektuese.

Bazat e trajnimit përfshinë punën e dobishme edukative me shpërblim përkatës, lehtësimin edhe inkurajimin e kontakteve mes te miturve dhe botes se jashtme përmes letrave, telefonit, pranimin e vizitave, vizitave ne shtëpi, aktiviteteve sportive dhe ofrimin e kushteve te nevojshme për kryerjen e ritualeve fetare. Ne qendrën korrektuese ne Lipjan te miturit kanë vizita ditore nga stafi i punëtorëve social, psikologeve, mjekeve, neuropsikiatërve, shërbimit sprovues dhe çdo here përcillet gjendja e tyre, si në aspektin mjekësor po ashtu edhe ne atë psikologjike.

⁸⁹ Ibid, neni 137.

⁹⁰ Ibid, neni 138-139.

3 Pranimi i te miturve ne qendrën korrektuese

Ligji ne fuqi rregullon dërgimin, qëndrimin dhe shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim për të mitur, caktimin e grupeve arsimore, te drejtat ne vizitë, përcaktimin e punës dhe edukimi, mundësin e shkollimit te rregullte me KDM-në.⁹¹ Çështja e ekzekutimit te dënimeve janë te parapare vetëm ne pika te përgjithshme, ndërsa me detaisht janë te parapara ne ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale⁹², mirëpo këto dispozita zbatohen përshtatshmërisht me burgim për te mitur. Te gjitha raportet, duke përfshire shënimet gjyqësore, medicinale, shënimet e procedurave disiplinore si dhe te gjitha duhet te vendosen ne një dosje individuale konfidenciale, e cila duhet te përtërihet me te dhëna te reja, te jete e hapur vetëm për personat e autorizuar, dhe te klasifikohet ne atë mënyrë qe te kuptohet lehtë. Me tu liruar i mituri shënimet për te duhet te mbyllen dhe një kohe te përshtatshme duhet te fshihen. Ne çdo vend ku te miturit janë te paraburgosur duhet te mbahen shënime te plota dhe te sigurta për çdo te mitur si; dita, ora e pranimit, transferimit dhe lirimit, detajet e njoftimit te prindërve etj.⁹³ Ne

⁹¹ KDM, neni 134.

⁹² Për më gjerësisht *shih*: dispozitat eLESPK-së..

⁹³ Rregullat e Kombeve të Bahkuar për mbrojtjen e të miturve që janë privuar nga liria, pika 21. Shih Linkun <http://archive.koha.net/?id=&l=135966>: Koalicioni i OJQ për mbrojtjen e fëmijëve (KOMF) dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) kanë identifikuar 3 raste gjatë vitit 2016, ndërkaq 6 raste të tilla janë evidentuar në vitin 2015 nga 48 të mitur sa janë në Qendrën Korrektuese në Lipjan. Kjo praktikë ka zgjatur që nga hyrja në fuqi e Kodit të Drejtësisë për të Mitur. “Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, derisa të miturit i është shqiptuar masë edukative apo burgim për të mitur, aktvendimet eventuale për vepra të tjera penale që janë ngritur para ose pas shqiptimit të masës edukative duhet të përfshihen në një aktvendim të vetëm – unik ndaj të miturit”, thuhet në këtë reagim. Sipas këtij reagimi, aplikimi i masave të dyfishta bie ndesh me dispozitat e KDM dhe ndikon në uljen e besimit tek të miturit për sistemin e drejtësisë dhe sistemin korrektues duke e parë atë si pengesë e jo ndihmë në risocializimin dhe re-integrimin e tyre “Të miturit të cilët kanë marrë edhe një masë pa përfunduar masa në ekzekutim, kanë tendencë të fillojnë shfaqjen e sjelljeve jo të mira si pasojë e rënies së vullnetit për sjellje të mira derisa janë nën masën apo dënimin aktual. Kjo praktikë u pengon atyre në rikthimin në jetën normale duke ua zgjatur qëndrimin në QKL”, theksohet më tej në reagim. Mbi këtë bazë, KOMF dhe QKRMT duke shfrytëzuar mjetin joformal – intervenimin e palës së tretë në interes të gjykatës (*amicus curiae*), i është drejtuar Gjykatës Supreme, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial me kërkesë që në bazë të autoritetit kushtetues dhe ligjor të ndërpritet praktika që ndaj të miturve të shqiptohet masë edukative e re ose dënim i ri me burgim derisa i mituri është në vuajtje të një mase apo dënimi. Shih: Startegjinë e të drejtave të njeriut në Kosovë 2016-2022, (Projekt i financuar nga BE-ja dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë), 2016. Të drejtat themelore të njeriut janë të mbrojtura në mënyrë të qëndrueshme në Kushtetutën e Kosovës. Promovimi dhe zbatimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve të Kosovës është i rregulluar me akte të ndryshme legjislative civile dhe penale, duke përfshirë pakon e legjislacionit të të drejtave të njeriut (p.sh. ligji kundër diskriminimit, ligji për Avokatin e Popullit dhe ligji për barazi gjinore), që ka hyr në fuqi në korrik të vitit 2015. Ligjet e reja kanë eliminuar mangësitë në ish kornizën ligjore duke rregulluar kuadrin jo-gjyqësor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe duke siguruar pajtueshmërinë me standardet evropiane të të drejtave të njeriut, dhe me konventat ndërkombëtare. Këto ligje janë, veçanërisht, të vlefshme meqë ato përcaktojnë kompetencat dhe ndërlidhjet në mes të organeve të ndryshme që kanë kompetenca në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore dhe konfirmojnë rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit, si organi kryesor kompetent në fushën e të drejtave themelore. Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e marrëveshjeve të mëdha ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Kushtetuta e Kosovës thotë se të

Qendrën Korrektuese për te mitur ne Lipjan nga pranimi i te miturit ne këtë qendër, ai kalon ne këto regjime te qëndrimit ne këtë institucion:

- Regjimi themelor , ku përfshinë pranimin e te miturit ne këtë qendër dhe shikimin se i mituri a mund ti mësoje rregullat e kësaj qendre. Ky regjim zgjat pese dite nga dita e pranimit,
- Regjimi standard, i cili është faze pasuese pas fazës se pare me te cilin i mituri mund te kaloje, nëse arrin qe t’iu përshtatet rregullave te cilat janë te parapara ne këtë institucion, i cili regjim zgjate tri deri gjashte muaj,
- Regjimi i avancuar është një nder regjimet me te përshtatshme për te miturin. Ne qofte se kalohet kjo faze e te miturit atëherë ai gëzon beneficione te ndryshme.

Një nder beneficionet është edhe pushimi 30 ditor brenda vitit, i cili mund te shfrytëzohet jashtë qendrës korrektuese.

gjitha instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Sipas Kushtetutës së Kosovës. Shih linkun: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/human_rights_strategy_for_kosovo_2016-2022_alb.pdf

4 Kategorizimi i personave të mitur gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim

Gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim duhet të pasur kujdes të shtuar, sepse, nëse dënimi nuk e arrin qëllimin, dhe nuk i trajtojmë në mënyrë profesionale dhe humane të mituri, atëherë mund të ndodh që ekzekutimin i dënimit me burgim për të mitur të marr rrugë tjetër, i cili nuk është në interes të përgjithshëm shoqëror. Burgim për të mitur mbahet në institucionin korrektues për të mitur dhe, në raste të jashtëzakonshme, në pavijone të ndara të institucionit korrektuese për personat madhorë. Institucionet korrektuese për të mitur janë të llojit gjysmë të hapur dhe të hapur, përjashtimisht të miturit mund ta vuajnë dënimin me burgim në institucionet korrektuese të tipit të mbyllur.⁹⁴ Gjithashtu, vuajtja e dënimit është ndarë edhe sipas gjinisë në institucione apo në pavijone të ndara brenda institucionit. Të miturit të cilët bëhen madhor gjatë ekzekutimit të dënimit, duhet të vendosen në pavijone të ndara të institucionit. Të miturit, e vuajnë dënimin e tyre me burgim në qendrën korrektuese për të mitur deri sa të mbushin moshën njëzetetë (23) vjet, e në raste akoma nuk e kanë përfunduar dënimin e dhënë nga gjykata, të miturit transferohen në qendrën korrektuese për të rritur. Përjashtimisht, të miturit që kanë mbushur moshën e lartcekur mund të qëndrojnë në institucionin korrektuese për të mitur nëse është e nevojshme për kryerjen e përgatitjes ose aftësisimit profesional, apo nëse të mituri i ka mbetur të vuaj dënimin më pak se gjashtë (6) muaj. Në mënyrë ekspllicit përcaktohet se i mituri nuk mund të qëndroj në institucionin korrektuese pasi t'i ketë mbushur moshën njëzeteshtatë (27) vjet.⁹⁵

Sipas, të drejtës pozitive të Kosovës parimisht është rregull që personat e mitur të vuajnë dënimin së bashku, përjashtimisht nuk e vuajnë dënimin me burgim nëse;

- I mituri ka parashtruar kërkesë për ndarje, dhe drejtori i qendrës korrektuese mund të lejon një veprim të tillë, në raste të shqyrtimit të kërkesës drejtori vlerëson së a është e arsyeshme dhe se nuk ka mundësi të tjera për trajtimin e shqetësimeve të të miturit,
- Drejtori mund të urdhëroj ndarjen e të miturve edhe pa kërkesë të të miturit, vetëm nëse masa e tillë është e nevojshme:
 1. Për të parandaluar rrezikun për jetë apo shëndet të të miturit a personave të tjerë,
ose

⁹⁴ Neni, 136, parag, 1 i KDM-së.

⁹⁵ Ibid., parag. 3.

2. Për të parandaluar kërcënimin ndaj sigurisë së institucionit korrektuese të shkaktuar nga prania e vazhdueshme e të mituri brenda përbrenda gjithë njerëzve të burgut.⁹⁶

Drejtori i institucionit korrektuese mund t'i lejojë të miturit të marrë pushim nga dy (2) herë në çdo vit për të vizituar familjen. Pushim zgjat deri në tridhjetë (30) ditë dhe sipas rregullit ai lejohet të shkoj në pushim kur nuk mbahet mësimi. Gjithashtu, i mituri ka të drejt të kalojë të paktën tri (3) orë gjatë ditës në ambiente të hapura brenda institucionit. Në mënyrë decisive përcaktohet se i mituri nuk i nënshtrohet vetmisë si dënim disiplinor.⁹⁷

⁹⁶ KDM, neni 37.

⁹⁷ Ibid., neni 138 dhe 139.

KAPITULLI III – ASPEKTET E SIGURISE TË SHQIPTIMIT TE DËNIMIT ME BURGIM

1 Procedura për shqiptimin e dënimit me burgim ndaj te miturve

Dënimi me burgim u shqiptohet vetëm atyre te miturve te cilët ne kohen e kryerjes se veprës penale kane mbushur moshën 16 vjet, si dhe te atyre personave te cilët kane kryer veprën penale si te mitur, e ne kohen e gjykimit nuk i kane mbushur 21 vjet. Me ligj është parapare se i mituri nuk mund te gjykohet ne mungese. Kur ndërmarrim ndonjë veprim me te cilin është i pranishëm i mituri dhe sidomos gjate marrjes se tij ne pyetje, organet qe marrin pjese ne procedure janë te obliguar, qe te veprojnë me kujdes duke marr parasysh zhvillimin psikologjik, ndjeshmërinë dhe karakteristikat personale te te miturit, ne mënyrë qe zbatimi i procedurës te mos ketë ndikim te kundërt ne zhvillimin e tij.

Gjate procedurës i mituri duhet te ketë mbrojtje te detyrueshme, kështu qe sipas dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të mitur, i mituri duhet te ketë mbrojtës që nga fillimi e deri në përfundim të procedurës.⁹⁸

Ne qofte se i mituri, përfaqësuesi i tij ligjor ose personat e gjinisë nuk angazhojnë mbrojtës, atë e cakton gjyqtari për te mitur sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike. Mbrojtësi i te miturit mund te jete vetëm avokat i regjistruar ne Oden e Avokateve.⁹⁹ Pas kapjes se një te mituri, njoftohen menjëherë prindërit e tij\ saj ose kujdestari dhe kur nuk është i mundur njoftimi i menjëhershëm i tyre, prindërit ose kujdestari do te njoftohet me pas edhe atë brenda një kohe sa me te shkurtër.¹⁰⁰ Prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari kane te drejte ta shoqërojnë te miturin ne te gjitha procedurat dhe nga ata mund te kërkohet qe te marrin pjese nëse kjo është ne interes te te miturit. Gjyqtari për te mitur mund ta përjashtoj prindin, prindin adoptues ose kujdestarin nga pjesëmarrja ne procedure, nëse përjashtimi i tille është ne interesin me te mire te te miturit, mirëpo nëse këta nuk kujdesen dhe nuk e kryejnë punën prindërore, atëherë gjykata mund te caktojë një kujdestar te përkohshëm për te miturin i cili përzgjidhet nga lista qe e ka ne evidence Qendra për pune sociale për punëtorët social, arsimtaret, pedagoget ose specialistet vullnetar nga mesi i te cilëve caktohet kujdestari i përkohshëm.¹⁰¹ Të gjitha të drejtat e të miturit gjatë procedurës penale duhet të respektohen

⁹⁸ KDM, neni 43, parag, 1.

⁹⁹ Ibid, parag. 2 dhe 6.

¹⁰⁰ Rregullat e Pekinit, neni 10, parag. 1.

¹⁰¹ KDM, neni 44.

dhe t'i ofrohet garanci juridike në përputhje me legjislacionin nationale dhe me traktatet ndërkombëtare.¹⁰²

Veçori tjetër e procedurës për shqiptimin e dënimit me burgim është edhe organi i kujdestarisë i cili pavarësisht nga kompetencat e parashikuara me ligj, organi i kujdestarisë ka te drejte te njoftohet për rrjedhën e procedurës, te bëjë propozime dhe te paraqesë fakte dhe prova te rëndësishme për marrjen e vendimit te drejte. Ky organ njoftohet nga prokurori i shtetit kurdo qe fillon procedura kundër te miturit. Ne rastin e marrjes se çfarëdo vendimi qe ka te bëjë administrimin e drejtësisë për te mitur, para se gjithash, duhet pasur parasysh se cili është interesi me i mirë i fëmijës. Fëmijët dallohen nga te rriturit sa i përket zhvillimit fizik dhe psikologjik si dhe nga nevojat emocionale dhe edukative. Dallimet e tilla paraqesin parimet baze për fajësinë me te vogël të fëmijëve qe bien ne konflikt me ligjin. Këto dhe dallimet e tjera janë arsytet për sistem te veçantë te drejtësisë për te mitur dhe kërkojnë trajtim te ndryshëm te fëmijëve. Mbrojtja e interesit me te mire te fëmijës nënkupton për shembull qe qëllimet tradicionale se drejtës penale (represioni, ndëshkimi) duhet t'ia lënë vendin rehabilitimit dhe drejtësisë korrektuese kur kemi te bëjmë me fëmijët qe janë kryes te veprës penale. Kjo mund te behet me marrëveshje duke i kushtuar kujdese sigurisë publike.¹⁰³ Asnjë fëmijë nuk i nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose te paligjshme ne jetën e tij private, ne familje, ne shtëpi ose ne korrespondencën e tij, as cenimeve te kundërligjshme te nderit dhe reputacionit te tij.¹⁰⁴

Te gjitha procedurat në të cilat përfshinë te miturit janë konfidenciale. Asnjë incizim i procedurës duke përfshirë dhe audio dhe video – incizimin nuk mund te behet publike pa autorizimin e gjykatës. Vetëm pjesa e vendimit te marre gjate procedurës autorizohet për publikun. Kur pjesa e autorizuar e incizimit te procedurës ose e vendimit behet publike, nuk zbulohen te dhënat personale qe mund te shfrytëzohen për identifikimin e te miturit.¹⁰⁵

¹⁰² Për më gjerësisht lidhur me garancit juridike të të drejtave të miturve në procedure penale, *shih*: Rregullat minimale standarde të OKB-së për trajtimin e të burgosurve, të adoptuar nga Kongresi I i Kombeve të Bashkuar për parandalimin e krimeve dhe trajtimin e delikuentëve, mbajtur në Gjenevë, më 1995 dhe miratuar nga Këshilli ekonomik e shoqëror me rezolutat e tij 663C (XXIV) të datës 31 korrik 1957 dhe 2076 (LKII) të datës 13 maj 1977; Rregullat e Pekinit; dhe Konventa mbi të Drejtave të Fëmijëve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithsme e Organizatës së Kombeve të Bashkuar me 20 nëntor 1989.

¹⁰³ Koment mbi të drejtat e fëmijëve (KDF), Sesioni I dyzetekatërt, 15 janar 2007, Gjenevë, fq. 3..

¹⁰⁴ KDF, neni 16, parag. 1

¹⁰⁵ KDM., neni 50.

Te miturit gjykohen nga trupi gjykues i cili ne shkalle te pare dhe ne shkallen e dyte përbehet nga një gjyqtar për te mitur dhe dy gjyqtar laike. Gjyqtaret laik ne trupin gjykues zgjidhen nga mesi i profesorëve, arsimtareve, edukatoreve, punëtorëve social, psikologeve me përvojë ne edukimin e te miturve. Këta gjyqtar laik qe marrin pjese ne trupin gjykues mund te jene te dy gjinive. Ndërsa ne kolegji në Gjykatën Supreme përbehet nga tre gjyqtar profesional ku në përbërje te tyre është se paku një gjyqtar për te mitur ndërsa kur ne gjykate hapet shqyrtimi atëherë gjykon trupi i madhe gjykues prej dy gjyqtareve për te mitur dhe tre gjyqtareve laike.¹⁰⁶ Sipas, KDM-së, kompetenca territoriale i japin, përparësi vendbanimit te te miturit, pra kompetente është gjykata ne vendbanimin e te miturit, ndërsa kur i mituri nuk ka vendbanim te përherëshëm atëherë përparësi i jepet vendqëndrimit te te miturit. Kjo kompetence është parapare me qellim qe i mituri te jete sa me i sigurte ne procedure dhe sa me afër familjes dhe rrethit shoqëror. Mirëpo procedura mund te shqiptohet edhe ne gjykatën ne territorin ne te cilin është kryer vepra penale nëse është e qartë se procedura do te zbatohet me lehte ne atë gjykate.¹⁰⁷

Ne procedure për te mitur, ndjekja ushtrohet ekskluzivisht sipas parimit te oficialitetit, sepse për te gjitha veprat penale procedura fillon vetëm ne baze te kërkesës te prokurorit shtetit.¹⁰⁸ Për veprat penale te dënueshme me burgim prej me pak se 3 vjet ose me gjobe, prokurori shtetit mund te vendose te mos e filloje procedurën përgatitore edhe pse ekziston dyshimi i bazuar se i mituri ka kryer vepër penale (parimi i oportunitetit). Nëse prokurori mendon se nuk do te ishte e përshtatshme te zbatohet procedura kundër te miturit për shkak te natyrës se veprës penale, te rrethanave ne te cilat është kryer ajo, mungese se demit te rende ose te pasojave për viktimën, si dhe te kaluarës se te miturit dhe te karakteristikave te tij personale. Po ashtu për veprën penale te re te cilën e kryen i mituri për derisa ekzekutimi i dënimit është duke vazhduar prokurori i shtetit mund qe te mos filloje ndjekjen penale ne qofte se e parasheh se nuk do te ishte e dobishme për te miturin, dhe për këtë e njofton organin e kujdestarisë. Ne qofte se është e nevojshme vërtetohet gjendja mendore e te miturit, atëherë gjyqtari për te mitur emëron ekspert përkatës te shëndetit mendor për vërtetim te gjendjes mendore, qofte ne kohen e kryerjes se veprës penale ose te konstatoje aftësinë e te miturit për t'u gjykuar, ose ne te dyja

¹⁰⁶ Ibid., neni 51.

¹⁰⁷ Ibid., neni 54.

¹⁰⁸ Sahit, Ejup, Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013, fq. 431.

rastet. Gjyqtari për të mitur caktimin e kësaj detyre e bën sipas detyrës zyrtare ose me kërkesën e prokurorit shtetit, të mbrojtësit, prindërve, prindërve adoptues apo të kujdestarit. Kontrolli bëhet në ambient të përshtatshëm dhe konfidencial. Mendimi i ekspertit për shëndetin mendor është konfidencial dhe mund t'i zbulohet gjykatës dhe palëve.¹⁰⁹

Nëse procedura përgatitore nuk përfundon brenda periudhës 6 mujore, prokurori i shtetit i dorëzon gjyqtarit për të mitur lutje të arsyetuar me shkrim për vazhdimin e procedurës përgatitore.¹¹⁰

¹⁰⁹ KDM, neni 56 dhe 57.

¹¹⁰ Ibid., neni 61.

2 Arrestimi dhe paraburgimi i të miturit

Arresti i përkohshëm, ndalimi në polici dhe paraburgimi i të miturit urdhërohet vetëm si mase e fundit për një kohë sa më të shkurtër të mundshme.¹¹¹ Personat e mitur që janë në paraburgim duhet të jenë të ndarë nga personat më të rritur, sepse që aty personat e mitur mund të infektohen nga kriminaliteti dhe po ashtu shoqërimi me persona më të rritur mund të ketë ndikim edhe në rrjedhën e procedurës penale. Të miturit që mbahen nën arrest apo të cilët e presin gjykimin “te pagjykuar” supozohen si të pafajshëm dhe duhet të trajtohen si të tilla. Paraburgimi para gjykimit duhet shmangur aq sa është e mundur dhe ai duhet të kufizohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Prandaj duhet të bëhen përpjekje për të përdorur masa alternative. Kur megjithatë shfrytëzohet parandalues, gjykata për të mitur dhe organet e hetuesisë duhet t’i japin përparësi me të madhe shqyrtimit me të shpejtë të rasteve të tilla për të siguruar kohëzgjatjen me të shkurtër të paraburgimit që është e mundur.

Të paraburgosurit e padënuar duhet të ndahen nga të miturit e dënuar. Paraburgimi në asnjë rast nuk guxon të konsiderohet si de facto dënimi para gjykimit edhe nëse procedura gjyqësore e merr në konsideratë kohëzgjatjen e paraburgimit. Paraburgimi nuk është sanksion por vetëm mase për sigurimin e preventives në procedurën penale. Ai imponohet vetëm për nevojën e hetimit kriminal. Qëllimi i tij është që të parandalojë marrëveshje të fshehta dhe arratisje. Fëmija para dënimit konsiderohet i pafajshëm.¹¹² Arresti i përkohshëm dhe ndalimi në polici duhet të jenë në afat sa më të shkurtër dhe nuk mund të kalojnë periudhën me të gjatë se 24 ore. Paraburgimi i të miturit urdhërohet nga gjyqtari për të mitur dhe vetëm atëherë kur është me se e domosdoshme për të siguruar praninë e të miturit, për t’u parandaluar kryerjen e serishme të veprës dhe për të siguruar zbatim të suksesshëm të procedurës. Gjyqtari për të mitur shqyrton nëse masat tjera nga KPP për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale apo masat e parapara në nenin 6 të KDM (që kanë të bëjnë me vendosjen e fëmijës në strehimore ose në institucionin edukativ apo të ngjashëm me vendosjen e fëmijës në kujdestari ose transferimin e fëmijës në familjen tjetër mund të urdhërohet si alternativ e paraburgimit.¹¹³ I mituri mund të mbahet në paraburgim me aktvendim fillestar për një periudhë maksimale prej 1

¹¹¹ KDM, neni 64.

¹¹² Prezantimi i programit i të miturve në konflikt me ligjin nga Organizata ndërkombëtare joqeveritare, *Therre Des Hommes*, fq. 5.

¹¹³ Sahit.: fq. 433-44.

muaji, nga dita kur ai është arrestuar. Paraburgimi i te miturit mund të vazhdohet vetëm nga kolegji për te mitur i gjykatës kompetente për një periudhë shtese deri në 2 muaj. Te miturit paraburgimin e mbajnë veçmas nga personat madhore.

Derisa janë në arrest, te miturit do të marrin kujdes, mbrojtjen dhe tere ndihmën e nevojshme sociale individuale, arsimore, profesionale, psikologjike, mjekësore dhe fizike, që ata mund të kërkojnë në baze të moshës, gjinisë dhe personalitetit të tyre.

3 Matja e dënimit me burgim

Rregullat të cilat i dedikohen matjes së burgimit për te mitur mund të ndahen në: rregulla të përgjithshme dhe në rregulla të posaçme. Dënimi me burgim është dënim me të cilin te miturit i privohen disa të drejta. Sipas Kodit të Drejtësisë për te mitur të Republikës së Kosovës, burgimi për te mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje me pak se 6 muaj, e as me shume se 5 vjet dhe shqiptohet në muaj dhe vite të plota. Maksimumi i burgimit për te mitur është 10 vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim afatgjate, ose kur i mituri ka kryer se paku dy vepra penale në bashkim-koneksi (lidhja e 2 veprave penale të njëpasnjëshme), ku secila është e dënueshme me burgim prej me shume se 10 vjet.¹¹⁴ Minimumi i kohëzgjatjes prej 6 muajve të burgimit për te mitur konsiderohet i domosdoshëm që të mund të merren masat përkatëse për edukim, riedukim dhe aftësim të tije profesional. Kemi cekur me lartë burgimin për te mitur se gjykata mund të shqiptojë vetëm për ato vepra penale për të cilat është parapare dënimi me burgim mbi 5 vjet. Gjykata është e kushtëzuar nga maksimumi i dënimit, i cili është parapare për atë vepër. Duke u bazuar në dispozitat e KDM-së dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje me të lartë se dënimi i parapare për atë vepër. Mirëpo, nëse për një vepër është parapare dënimi me burgim gjere 18 vjet, dënimi për te mitur nuk mund të shqiptohet me tepër se 5 vjet burgim.

Minimumi i posaçëm i dënimit të parapare për vepër penale nuk e obligon gjykatën me rastin e matjes së burgimit për te mitur. Kështu për shembull, nëse për veprën penale të kryer është parapare minimumi i dënimit me burgim prej 5 vjetësh, te miturit për atë vepër mund t'i shqiptohet burgimi për te mitur në kohëzgjatje me të shkurtër se 5 vjet, por jo me pak se 6 muaj.

¹¹⁴ KDM, neni 34.

Zgjedhja e këtyllë i bene te mundshme gjykatës qe te miturit t'i shqiptoje dënim me te lehte se kryesit madhore te veprës penale.¹¹⁵ Gjykata është e obliguar qe me rastin e shqiptimit te dënimit me burgim t'i marre parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato renduese.

Përveç rregullave te përgjithshme, Gjykata është e obliguar qe me rastin e matjes se dënimit për te mitur te marre parasysh edhe rrethana te posaçme, e te cilat anë:

- gjykata është e obliguar te marre parasysh shkallen e zhvillimit shpirtëror te te miturit. Shkalla e caktuar e zhvillimit shpirtëror përcaktohet ne baze te përgjegjësisë dhe fajësisë,
- grupi i dyte i rrethanave, qe kane madje edhe ndikim dominant ne caktimin e lartësisë se burgimit për te mitur, është koha e cila nevojitet për edukim, riedukim, arsimim dhe aftësimin e tije profesional.¹¹⁶

¹¹⁵ Salihu¹, fq. 78.

¹¹⁶ Ibid.,

4 Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burgim

Sikur te dënimet e tjera, ashtu dhe dënimi me burgim për te mitur duhet te ekzekutohet brenda periudhës se caktuar. Me kalimin e këtij afati, ekzekutimi i dënimit me burgim parashkruhet dhe nuk mund te ekzekutohet. Kështu, Kodi i drejtësisë për të mitur përcakton se dënimi me burgim për te mitur nuk mund te ekzekutohet nëse kane kaluar periudha kohore;

- 5 vjet nga vendimi i formës se prere me te cilin është shqiptuar burgim për te mitur për me shume se 5vjet,
- 3 vjet nga vendimi i formës se prere me te cilin është shqiptuar burgim për te mitur për me shume se 3 vjet, dhe
- 2 vjet nga vendimi i formës se prere me te cilin është shqiptuar burgim për te mitur deri ne 3 vjet.¹¹⁷

Këto afate te parashkrimit te ekzekutimit te këtij lloj dënimi llogariten nga dita kur aktgjykimi me te cilin është shqiptuar burgimi për te mitur te ketë marre formën e prere. Nëse i referohem sot raporteve ndërkombëtare mbi punën e gjykatave, atëherë vërejmë se gjykata në Kosovë janë të stërngarkuar me punën e tyre, për shkak se ekziston një numër i vogël i gjyqtarëve

¹¹⁷ KDM, neni 36. Sipas Qëndrimit Parimor të Gjykatës Supreme Agj. Nr. 314/2012, thekson se Ekzekutimi i dënimit me burgim nuk mund të fillojë , nëse ka arritur afati i parashkrimit absolut dhe gjithashtu dënimi nuk mund të vazhdojë të ekzekutohet , nëse gjatë mbajtjes së dënimit është arritur afati absolut i parashkrimit të dënimit. Në arsyetimin e këtij qendrimi parimor trajtohet se në praktikën e gjykatave në Kosovë ka mëdyshje nëse dënimi duhet të ekzekutohet ose jo brenda afatit absolut , përkatësisht kur i dënuari ka filluar mbajtjen e dënimit, a mund të arrihet afati i parashkrimit absolut. Në disa gjykata po zbatohet praktika, sipas së cilës nuk mund të bëhet fjalë për arrijtjen e afatit absolut të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, nëse i dënuar ndodhet në vuajtje të dënimit. Sipas rezonimit të këtyre gjykatave, nëse i dënuar është dërgu në vuajtje të dënimit një orë para arrijtjes së afatit absolut të parashkrimit, ai duhet ta vuajë dënimin në tërësi, ngase është evituar arrijtja e mundësisë së afatit absolut të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit. Pra Kodi Penal i Kosovës në mënyrë eksplicite parasheh se nëse kanë kaluar afatet e përcaktuar ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillon ose nëse ka filluar ai ndërpritet. Kjo koniston se pas kalimit të kohës së përcaktuar me ligj, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet. Afati i parashkrimit fillin të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi e ka marrë formën e prerë, por nëse është revokuat dënimi alternativ, nga dita kur vendimi mbi revokim është bërë i plotfuqishëm. Nëse dënimi me gjob nuk është paguar , zëvendësohet me dënim me burgim parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita kur vendimi i gjykatës për revokim është bërë i plotfuqishëm. Nëse parashkrimi ka ndodhur para se të jetë aktgjykimi i formës së prerë atëherë kemi të bëjmë me parashkrim të ndjekjes penale. Ndërsa për parashkrim të ekzekutimit të dënimit me burgim për të mitur vlejne dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të mitur. Për më gjerësiht shih Vendimin e gjykatës Supreme.

5 Lirimi me kusht

Një tjetër institut i së drejtës në Kosovë, iu jep mundësi të dënuarve për vepra të ndryshme penale, që ta shijojnë lirinë jashtë grilave të burgut. Në literaturën shkencore penale, lirimi me kusht vlerësohet si një masë bashkëkohore penologjike me rëndësi të madhe në lëmin e së drejtës penale dhe të politikës kriminale. Me anë të këtij institucioni të dënuarit motivohen që më shpejt të përmirësohen dhe të aftësohen për jetë normale në liri. Instituti i Lirimit me Kusht është një institut i ri i së drejtës penale. Për herë të parë ishte paraqitur në Angli, në gjysmën e shekullit XIX, ndërsa më pas edhe në Francë. Përvetësimi i këtij instituti në legjislacionet dhe praktikën e të gjitha vendeve të Evropës dhe shumë vende të botës u bë në fillim të shekullit XX. Në Kosovë, për dallim prej institutit të Faljes, i cili ka filluar së voni të zbatohet, instituti i Lirimit me Kusht, ka filluar të zbatohet pas përfundimit të luftës në Kosovë, qysh prej vitit 2002 nën autoritetin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (do të përdoret shkurtesa UNMIK).¹¹⁸

Literatura shkencore e së drejtës penale, thekson se lirimi me kusht është një instrument i cili iu jep sinjal personave të dënuar se me përmirësimin e tyre, ata mund të lirohen nga vuajtja e dënimit me burg para kryerjes në tërësi të dënimit. Pra, shërben si nxitje dhe stimulim i madh që të dënuarit të jenë më aktiv në trajtimin e risocializimit të tyre jo vetëm në entin ndëshkues-përmirësues por edhe jashtë tij, në liri.¹¹⁹ Lirimi me kusht i personave të dënuar është institucion i rëndësishëm, te cilin e njohin të gjitha legjislacionet penale dhe penitensiare të shteteve të bashkëkohore, te cilat e kanë pranuar sistemin modern të ekzekutimit të dënimit me burgim. Ky institucion ka një histori të gjatë të zhvillimit dhe të transformimit që nga paraqitja e tij e deri në ditët e sotme. Sipas të dhënave nga literatura, për herë të parë ky institucion paraqitet në sistemin progresiv të ekzekutimit të dënimit me burgim.¹²⁰ Lirimi me kusht ka të bëjë me lirimin e të dënuarit nga mbajtja e dënimit para se ta kryejë dënimin e plotë, nëse i ka plotësuar kushtet e caktuara dhe paraqet një mjet të rëndësishëm për nxitjen dhe stimulimin e personave të dënuar në procesin e risocializimit të tyre.

¹¹⁸ Musliu, Betim. Gashi Ademi, "Falja në Kosovë – Analizë e zbatimit të institutit të faljes dhe lirimit me kusht", të publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, Prishtinë, 2012, fq. 33.

¹¹⁹ Ibid.,

¹²⁰ Gashi, Rexhep², Lirimi me kusht i personave të dënuar në legjislacionin dhe në praktikën Kosovare, Revista, "E drejta", nr. 2/2004, të botuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, fq. 39.

Bazuar në Kodin Penal të Kosovës, lirimi me kusht mund t'i jepet personit të dënuar, sjelljet e të cilit gjatë vuajtjes së dënimit janë të mira dhe nëse ekziston baza e arsyeshme se ai nuk do të kryejë veprë të re penale. Pra, lirimi me kusht synon ri-integrimin e personit të dënuar në shoqëri dhe ta përgatisë atë që të udhëheq jetën në një mënyrë të përgjegjshme sociale, pa kryer vepra penale. Po ashtu, kjo i shërben qëllimit të mbrojtjes së shoqërisë për të parandaluar kryerjen e veprave të mëtejme penale. Përveç të dënuarit kërkesën për lirim me kusht mund ta bëjnë edhe drejtorët e Institucioneve Korrektuese, të cilët mund t'ia dorëzojnë Panelit për Lirim me Kusht dosjen me propozimin për lirim me kusht.¹²¹ Për secilin lirim me kusht, LESPK-së, përcakton detyrimin e atyre që e fitojnë këtë të drejtë, që pas lirit me kusht të nënshkruajnë marrëveshje për mbikëqyrje nga ana e Shërbimit Sprovues të Kosovës. Kodi Penal ka sanksionuar edhe rastet kur të liruuarit me kusht, nuk i përfillin kushtet e përcaktuara me rastin e dhënies së kësaj të drejte, të cilat rezultojnë me revokimin e lirit me kusht.¹²²

Ndaj te miturit i cili është duke mbajtur burgun për te mitur mund te caktohet lirimi me kusht nëse e ka mbajtur një te tretën e dënimit që i është shqiptuar. Mirëpo, te miturit nuk mund t'i caktohet lirimi me kusht para se te ketë qëndruar 6 muaj ne institucionin korrektues, përkatësisht ne paralelen për te mitur, sepse për një kohe me te shkurtër se 6 muaj supozohet se nuk mund te realizoje qëllimin e riedukimit dhe edukimit te delinkuentit te mitur. Lirimi me kusht nuk mund te caktohet derisa i dënuari i mitur te ketë mbajtur gjashte muaj edhe nga shkakut se minimumi i përgjithshëm i burgimit për te mitur siç e cekem është gjashte muaj.¹²³ Personi i dënuar me burgim për te mitur mund të lirohet me kusht nëse e ka mbajtur së paku një të tretën (1/3) e dënimit që i është shqiptuar. Pas lejimit te lirit me kusht, gjykata munde te shqiptoje masën e mbikëqyrjes se shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit apo organit te kujdestarisë deri ne përfundim te dënimit te shqiptuar.¹²⁴

Lirimi me kusht mund te revokohet nëse gjate kohës se lirit me kusht i mituri kryen veprë penale për te cilën shqiptohet burgimi ose burgimi për te mitur prej se paku gjashte muaj¹²⁵, ndërsa për vendosjen me lirim me kusht të të miturit vendos Paneli për Lirim me

¹²¹ Musliu.: fq. 33-34.

¹²² Ibid.,

¹²³ Salihu¹, fq. 82.

¹²⁴ KDM, neni 35, paragraf 1 dhe 2.

¹²⁵ Ibid., paragraf 3; Për më gjerësi shih: Musliu.: fq. 33-36 Të drejtë për të kërkuar lirim me kusht nga Paneli ka secili person, i cili është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm. Kërkesa për lirim me kusht është e pranueshme sipas kushteve: specifike të cilat parashihen në kapitullin III, tek alineja 3, në Urdhëresën mbi qeverisjen e Panelit për Lirim

Kusht.¹²⁶ Meqenëse, kishte qenë i vetmi mekanizëm funksional për lirinë e të dënuarve së paku me kusht, Paneli për Lirim me Kusht, ishte shndërruar në njëren prej adresave më të kërkuara nga të dënuarit. Rritja e numrit të kërkesve për lirim me kusht ndër vite ka ekspozuar Panelin për Lirim me Kusht ndaj shumë problemeve. Rritja rëndësisë të këtij instituti njëkohësisht ka rritur mundësinë e keqpërdorimit të tij. Në fakt, kjo edhe kishte ndodhur për vite të tëra, ku liria me kusht e dhënë nga gjykatësit e këtij paneli ishte shndërruar në biznes, për të cilin vetë të dënuarit apo familjarët e tyre kishin negociuar për ta blerë atë me para.¹²⁷

KAPITULLI IV - VËSHTRIMI KRAHASIMOR I SANKSIONEVE PENALE NDAJ TË MITURVE NË KOSOVË ME MAQEDONIEN DHE SHQIPËRINË

me Kusht. Këtu përfshihen kriteret sipas të cilave të dënuarit në raste specifike mund të kenë kërkesën e pranueshme vetëm nëse kanë vuajtur gjysmën, 1/3 apo ¼ e dënimit apo për të miturit, të cilët kanë vuajtur 1/3 e dënimit. Kriteret për të vlerësuar nëse janë plotësuar kushtet për të liruuar të dënuarit me kusht përcaktohen në Urdhëresat që qeverisin Panelin për Lirim me Kusht.

¹²⁶ Paneli për Lirim me Kusht (shkurtesa: PLK), është organ i veçantë dhe i pavarur në vendimmarrje, i themeluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Paneli përbëhet prej tre (3) anëtarëve: një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme; një (1) prokuror i Shtetit, si dhe një (1) përfaqësues nga Policia e Kosovës (MPB). Në përbërje të panelit është i emëruar edhe një (1) përfaqësues i deleguar nga Fakulteti Juridik, si anëtar i katërt, i cili është përzgjedhur për të qenë në gatishmëri për të vendosur në rastet kur me ligj parashihet përjashtimi i anëtarit të panelit në një çështje të caktuar, apo zëvendësimi në mungesë të ndonjë anëtari tjetër. Paneli është kompetent për shqyrtimin e të gjitha kërkesave dhe propozimeve për lirim me kusht, në bazë të raporteve të përpiluara nga ekipet profesionale të Institucioneve Korrektuese të Kosovës. Kundër aktvendimit të Panelit nuk lejohet ankesa dhe nuk mund të ngritet konflikt administrativ. Paneli mbështetet dhe përfaqësohet nga Koordinatorin, roli dhe funksioni i të cilit është përcaktuar në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Koordinatorin i Panelit për lirim me kusht, është përgjegjës për të gjitha punët dhe aktivitetet mbështetëse të panelit, duke u kujdesur për mbarëvajtjen e punëve të Panelit për Lirim me kusht dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për procedurat përkatëse me rastin e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave të personave të dënuar, të parashtruara nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, si dhe koordinon aktivitetet me Shërbimin Sprovues të Kosovës, në lidhje me mbikëqyrjen e personave të liruuar me kusht. Shih linkun: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/page/index/389>.

¹²⁷ Për më gjerësisht *shih*: Musliu.: fq. 36-37.

Në janar të vitit 2011, Policia e Kosovës kishte arrestuar një nga gjykatësit laik të PLK-së nën dyshimin se kishte marrë mito për lirim me kusht të të burgosurit. Bashkë me këtë gjykatës, Njësi i Policisë së Kosovës për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Pejë, kishte prangosur edhe dy të dyshuar të tjerë, për të cilët hetuesit dyshonin se të njëjtit në mënyrë të kundërligjshme ua kishin mundësuar lirim me kusht të burgosurve, pa i plotësuar kriteret ligjore. Veprat penale për çka ndiqeshin këta persona ishin: shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit, marrje e ryshfetit, dhënie e ryshfetit. Prangosja e këtyre personave, ishte bërë pas marrjes së informacionit nga Burgu i Dubravës në Istog se Paneli për Lirim me Kusht të të dënuarve është duke marrë ryshfet për lirim me kusht të të dënuarve pa plotësimin e kriteve. Policia e Kosovës kishte njoftuar se përveç gjykatësit, dy të dyshuarit e tjerë kishin shërbyer si ndërmjetësues në gjetjen e familjeve të personave që janë në vuajtje të dënimit në burgje dhe më pas ua kishin caktuar shumat e të hollave për lirim me kusht të tyre. Pra, dyshimet e ngritura në këtë rast, nxjerrin në shesh një grup të strukturuar me role të ndara për të përfituar financiarisht duke kryer veprat penale të marrjes dhe dhënies së ryshfetit. Të marr nga: *Ibid.*, fq. 38.

1 Sanksionet penale ndaj të miturve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Maqedonisë

Sistemi i dënimeve në Republikën e Maqedonisë ka pësua ndryshime pas vitit 2004. Këto ndryshime kanë të bëjnë me zgjerimin e reportorit të dënimeve për personat madhore¹²⁸ por edhe për personat e mitur. Në sistemin bashkëkohor juridik-penale dhe në sistemin e sanksioneve penale, zakonisht masat edukuese ndaj të miturve ndahen në dy grupe kryesore.¹²⁹ Një ndarje dhe klasifikim i masave edukative përmirësuese ndaj personave të mitur pak a shumë haset në ligjet pozitive mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të shteteve bashkëkohore.¹³⁰

Sipas Ligjit mbi drejtësinë për të mitur i Maqedonisë (do të përdoret shkurtesa LDMM), qëllimi i tij është realizimi i interesit prioritar dhe mbrojtja e të miturve nga kriminaliteti, dhuna dhe nga çfarëdo qoftë forme e rrezikimit të të drejtave dhe lirive të tyre dhe zhvillimin e tyre të drejtë; mbrojtjen e të miturve kryerës të veprave që me ligj janë cilësuar si vepra penale dhe kundërvajtje të përsëritura, socializmin e tyre, edukimin dhe riedukimin, ndihmën dhe përkujdesjen e të miturve dhe mbrojtjen në procedurë para gjyqit dhe para organeve të tjera të të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Konventën e të drejtave të fëmijës dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për pozitën e të miturve në sistemin e drejtësisë, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.¹³¹ Gjithashtu, edhe LDMM -ja ka përvetësuar parimin e ligjshmërisë se të miturit nuk mund t'i shqiptohet sanksion i paraparë me këtë ligj, për veprim që para se të kryhej nuk ka qenë me ligj i cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje dhe për të cilin nuk ka qenë i përcaktuar sanksion me ligj.¹³² Gjatë zbatimit të masave dhe sanksioneve edhe në procedurat e përcaktuara me këtë ligj të miturit mund t'i merren ose t'i kufizohen të drejtat e caktuara vetëm në masë që përgjigjet me shkallën e arritur të zhvillimit të personalitetit të tij dhe të nevojës së tij për mënjanimin e gjendjeve që ndikojnë që ai të bëjë vepra penale ose kundërvajtje.¹³³ Masa ose sanksioni që i shqiptohet të miturit duhet t'i përgjigjet personalitetit të tij, peshës së veprës që

¹²⁸ Kambovski Vllado, E drejta penale – Pjesa e përgjithshme (E përkthyer në gjuhën shqipe nga Osmani Afrim dhe Zejneli Ismail), Shkup, 2010, fq. 504.

¹²⁹ Zejneli, fq. 119.

¹³⁰ Ibid.,

¹³¹ Ligj mbi drejtësinë për të mitur i Republikës së Maqedonisë, të publikuar në Gazetën zyrtare të RM, nr. 87.2007, neni 2.

¹³² Ibid., neni 3.

¹³³ Ibid., neni 6.

me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje dhe pasojat e saj, nevojën e edukimit të tij, riedukimin, arsimimin dhe zhvillimin, me qëllim të sigurimit dhe mbrojtjes së interesit më të mirë për të miturin.¹³⁴

Sipas legjislacionit pozitiv të Maqedonisë ndaj të miturit të vogël për veprim që me ligj është përcaktuar si vepër penale mund të shqiptohen vetëm masa edukuese. Ndërsa ndaj të miturit të madh për veprim që me ligj është përcaktuar si vepër penale mund të shqiptohen masa edukuese, e me përjashtim mund t'i shqiptohet dënim ose masë alternative.

Kryerësit të mitur të veprës penale mund t'i shqiptohen këto masa edukuese të cilat ndahen në tri grupe dhe secili grup ka nëngrupe të masave. Ato masa janë: Masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe masat e entit.¹³⁵ Masat disiplinore ndahen në: qortim ose udhëzim në qendrën disiplinuese për të mitur, masat e mbikëqyrjes së përforcuar¹³⁶ janë : nga ana e prindërve ose kujdestarit, familjes që përkujdeset ose nga ana e qendrës dhe masat e entit: udhëzimi në entin edukues ose në shtëpinë edukuese korrektuese¹³⁷.

Sipas nenin 43 të LDMM -së, i mituri i madh me përgjegjësi penale nëse për shkak të pasojave të rënda nga vepra penale dhe shkallës së lartë të përgjegjësisë penale mund të shqiptohet dënimet kryesore nëse nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohet ndonjë masë

¹³⁴ Ibid., neni 8.

Sipas nenit 12 të LDMM -së, i mitur është çdo person në moshë deri në 18 vjet, i cili sipas Konventës për të drejtat e fëmijës konsiderohet si fëmijë, fëmijë në rrezik është i mituri i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje, ka mbushur shtatë vjet, e nuk i ka mbushur katërmëdhjetë vjet; fëmijë në rrezik konsiderohet edhe i mituri me moshë deri në 14 vjet-i varur nga përdorimi i drogave, substancave psikotropike ose alkooli, fëmijë me pengesa në zhvillim, fëmija-viktimë e dhunës dhe fëmija i braktisur në aspektin e edukimit dhe atë social që gjendet në situatë të tillë në të cilën është vështirësuar ose pamundësuar realizimi i funksionit edukativ i familjes, ose fëmija nuk është përfshirë në sistemin e arsimit dhe edukimit ose është dhënë pas lypësisë, breddhjes ose prostitucionit, i cili për shkak të gjendjeve të tilla është ose mund të bie ndesh me ligjin. I mitur i vogël është i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje, i ka mbushur katërmëdhjetë vjet, ndërsa nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet. i mitur i madh është i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje, ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet, ndërsa nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet. - person madhor i ri është personi i cili në kohën e gjyqimit për vepër penale i ka mbushur tetëmbëdhjetë, ndërsa nuk i ka mbushur njëzetë e një vjet.

¹³⁵ Zejneli², fq. 120.

¹³⁶ Masat e mbikëqyrjes së përforcuar është e njëjte si me masat e mbikëqyrjes së shtuar në Republikën e Kosovës, por këtu vetem ka dallim terminologjike, ndërsa substanca dhe qëllimi është i njëjtë.

¹³⁷ LDMM -së, neni 31. Masat disiplinore shqiptohen ndaj të miturit kur nuk ekziston nevoja për masat më afatgjate të edukimit, e veçanërisht nëse ka kryer vepër penale nga të pakujdesia ose nga mendjehetësia.

Masat e mbikëqyrjes së përforcuar shqiptohen ndaj të miturit kur ekziston nevoja e masave më afatgjata të edukimit, riedukimit ose shërimit me mbikëqyrje adekuate, kurse nuk është e nevojshme ndarja e plotë e tij nga mjedisi i deriatëhershëm.

Masat e entit shqiptohen ndaj të miturit kur ekziston nevoja për masa më afatgjata të edukimit, riedukimit ose shërimit dhe ndarjes së tij të plotë nga mjedisi i deriatëhershëm. Kohëzgjatja e këtyre masave nuk mund të jetë më gjatë se pesë vjet, por më së shumti deri në arritjen e moshës njëzetë e tre vjeçe.

edukative. Sipas të drejtës pozitive të Maqedonisë të miturit të madh mund t'i shqiptohen këto dënime: burg për të miturit, dënim me para, ndalesa për drejtim me automjet të llojit të caktuar ose kategorisë së caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi. Burg për të miturit mund të shqiptohet vetëm si ndëshkim kryesor. Dënim me para mund të shqiptohet si dënim kryesor. Me përjashtim, për vepra penale të kryera me interes përfitimi, dënimi me para mund të shqiptohet si dënim dytësor së bashku me dënimin me burg për të mitur ose me dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse kur është përcaktuar dënim me burg për të mitur. Ndalimi për drejtim me automjet të llojit të caktuar ose të kategorisë dhe dëbimi i të huajit nga vendi mund të shqiptohen si dënim kryesor ose si dënim dytësor me dënim me para.

Burg për të mitur mund t'i shqiptohet të miturit të madh për përgjegjësi penale, që ka kryer vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej pesë vjetësh ose dënim më të rëndë, nëse vepra është kryer në rrethana veçanërisht të rënda dhe gjatë shkallës së lartë të përgjegjësisë penale të kryerësit dhe me ç'rast nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohej masa edukative. Vuajtja e burgut për të miturit nuk mund të jetë më i shkurtër se një vit as më i gjatë se dhjetë vjet, kurse shqiptohet në vite të plota ose në gjysmën e vitit. Gjatë llogaritjes së dënimit të miturit të madh për vepër të përcaktuar penale, gjykata nuk mund t'i shqiptojë burg për të mitur në kohëzgjatje më gjatë se dënimi i përcaktuar me burg për atë vepër, por gjykata nuk është e lidhur për masën më të vogël të përcaktuar për atë dënim.¹³⁸

Dënimi me gjobë për kundërvajtje mund të përcaktohet në shumë e cila nuk mund të jetë më e vogël së 15 euro kundërvlerë në dinar e as më e madhe se 800 euro kundër vlerë me dinar.¹³⁹

Ndërsa masat alternative sipas dispozitave të LDMM -së janë: gjykim i kushtëzuar me mbikëqyrje të mbrojtur, ndërprerje e kushtëzuar e mbajtjes së procedurës ndaj të miturit, dhe punë me dobi të përgjithshme.¹⁴⁰ Po ashtu edhe masat e sigurisë ndahen në: mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në entin shëndetësor, mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve.¹⁴¹

¹³⁸ LDMM -së, neni 44.

¹³⁹ Zejneli², fq. 148.

¹⁴⁰ LDMM -së, neni 53.

¹⁴¹ Ibid., 58.

2 Procedura për ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj të miturve në institucionet korrektuese të Republikës së Maqedonisë

Në Republikën e Maqedonisë sipas sistemit të së drejtës pozitive gjykata themelore është organ kompetent për shqiptimin dhe ekzekutimin e dënimit. Gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar është formuar sektori i specializuar për kriminalitetin e të miturve i përbërë nga: gjykatësi për të mitur, këshilltarët për të mitur dhe këshillat për të mitur.¹⁴² Sipas nenit 94 të LDMM-së, Gjykatësi për të mitur e zbaton procedurën përgatitore, merr vendime, kryeson me këshillin për të mitur dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj.¹⁴³ Këshilli për të mitur në gjykatën themelore përbëhet nga gjykatës për të mitur dhe dy gjykatës porotë. Gjykatësi për të mitur është kryetar i këshillit. Ndërsa gjykatësit - porotë zgjidhën nga radhët e punëtorëve të arsimit, psikologëve, pedagogëve, sociologëve dhe personave të tjerë të cilët kanë përvojë në edukimin dhe arsimimin e të rinjve. Këshilli për të mitur në gjykatën themelore vendos në shkallë të parë në procedurën për vepra penale dhe vendos për ankesat kundër aktvendimeve të gjykatësit për të mitur dhe në rastet e parashikuara me këtë ligj. Këshilli për të mitur të gjykatës së apelit, i përbërë nga gjykatës për të mitur dhe dy gjykatës, vendos për ankesat kundër vendimeve të këshillit për të mitur të gjykatës themelore, si dhe në raste tjera të përcaktuara me këtë ligj. Ndërsa në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë formohet këshill për të mitur i përbërë nga pesë gjykatësish. Këshilli për të mitur vendos në këshillat juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme të parashikuara me këtë ligj, dhe e ndjek edhe punën e përparimit të praktikës gjyqësore në këtë sferë dhe përgatit analiza.¹⁴⁴

Procedura ndaj të miturve për vepra penale ngrihet vetëm me kërkesën e prokurorit publik. Për vepra penale për të cilat ndiqet me propozim ose padi private, procedura mund të ngrihet nëse i dëmtuari në afat prej tre muajsh nga njoftimi për vepër të kryer ose kryerësi, ka bërë propozim për ngritjen e procedurës te prokurori kompetent publik.¹⁴⁵

Procedura ndaj të miturve është urgjente edhe kur bëhet fjalë për vepër penale nuk mund të zgjasë më shumë se një vjet, për veç për vepra penale për të cilat është përcaktuar dënim me

¹⁴² Zejneli², fq. 141.

¹⁴³ Gjykatësi për të mitur, prokurori publik, avokati dhe personat zyrtarë të autorizuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme së paku katër deri dhjetë ditë gjatë vitit ndjekin trajnim të specializuar për delikuencën e të miturve në vend ose në vendet e huaja.

¹⁴⁴ LDMM-së, neni 95 dhe 96.

¹⁴⁵ Ibid., neni 99.

burg prej së paku katër vjetësh, kur procedura nuk mund të zgjasë më shumë se një vjet dhe gjashtë muaj, ose kur bëhet fjalë për kundërvajtje - më shumë se gjashtë muaj.¹⁴⁶ Në procedurën për të mitur marrin pjesë, prokurori për të mitur, mbrojtësi është i obliguar, prindërit ose tutori, i dëmtuar por gjykata mund të lejoj të marrin pjesë edhe personat për edukimin e fëmijëve, mbrojtjen e fëmijëve dhe Avokati i popullit.¹⁴⁷

Në burgun për të mitur organizohet edhe përcjellja e mësimit fillor, zgjedhja e ndjekjes së mësimit varet shumë nga vetë mundësia e burgut. Në ato ente ku nuk ka kushte për organizimin e mbajtjes së mësimit, mësimin të miturit do ta ndjekin në shkollën e qytetit në të cilin e vuajnë dënimin. Sa i përket ruajtjes së shëndetit të të miturit dhe ruajtjes së zhvillimit fizik të tij, ligdhënësi ka parapar ushqim të fortë e cila në ditë duhet të ketë së paku 14.600 xhuli. Në këtë kontekst është edhe puna e ekipit mjekësor, ku mjeku duhet të ketë njohuri edhe në fushën e psikiatrisë mjekësore. Në kuadër të masave disiplinore, të miturit janë parapar masa më të buta, por mund të shqiptohet edhe masa e izolimit, e cila nuk mund të zgjatë më shumë se dhjetë ditë.¹⁴⁸

¹⁴⁶ Ibid., neni 81, paragrafi 2.

¹⁴⁷ Ibid., neni 85.

¹⁴⁸ Zejneli², fq. 143.

3 Sanksionet penale ndaj të miturve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës Shqipërisë

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve paraqet një rolë të rëndësishëm të politikave shtetërore të Shqipërisë. Një vëmendje të veçantë në këtë kuadër është treguar ndaj fëmijëve që janë në konflikt me ligjin duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme sistemin e drejtësisë për të mitur në përputhje me standardet ndërkombëtare.¹⁴⁹ Në Shqipëri është bërë progres në administrimin e drejtësisë për të miturit për ta bërë sistemin sa më njerëzor duke ofruar garanci ligjore dhe procedurale, dhe duke kaluar nga një sistem ndëshkues në një sistem me një qasje të drejtësisë që edukon dhe ri-integron.¹⁵⁰

Sistemi i sanksionimit të kryerësve të mitur të veprave penale në Shqipëri ka pësuar ndryshime thelbësore. Deri në vitin 2017, sanksionet penale ndaj të miturve janë parapara në Kodin Penal të Shqipërisë¹⁵¹, (do të përdoret shkurtesa KPSH-së) por gjatë vitit 2017 Shqipërisë dhe në tërësi sistemi i drejtësisë ka bërë hapa të mëdha në drejtimin të unifikimit të legjislacionit pozitiv me standardet ndërkombëtare. Kodi i Drejtësisë Penale për të mituri i Shqipërisë (në tekstin e mëtejshëm do të përdoret shkurtesa KDPMSh-së)¹⁵² i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2018, ka pësua ndryshime materiale, procedurale dhe ekzekutive.

Sipas diapozitiva të KDPMSh-së, përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.¹⁵³ Në nenin 3 të KDPMSh-së, përcaktohet se me nocionin “i mitur”, nënkuptojmë personin i cili nuk e

¹⁴⁹ Sufaj, Femi, “Sistemi i drejtësisë për të mitur në Shqipëri krahasuar me standartet ndërkombëtare,” fq. 63, të marr nga faqja e internetit: http://www.ajls.org/doc/5_FSufaj_Takimi_V.pdf.

¹⁵⁰ https://www.unicef.org/albania/sq/children_28174.html, të marrë me datën: 05-06-2018.

¹⁵¹ Ligji, nr. 7895, datë, 27.01.1995, Kodi Penal i Shqipërisë, i përditësuar dhe ndryshuar me ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.4.1997; nr. 8279, datë 15.1.1998; nr. 8733, datë 24.1.2001; nr. 9017, datë 6.3.2003; nr. 9030, datë 13.3.2003; nr. 9086, datë 19.6.2003; nr. 9188, datë 12.2.2004; nr. 9275, datë 16.9.2004; nr. 9686, datë 26.2.2007; nr. 9859, datë 21.1.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr. 23/2012, datë 1.3.2012; nr. 144, datë 2.5.2013; nr. 98, datë 31.7.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/ 2015, datë 5.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.7.2016; nr. 36/2017, datë 30.3.2017; nr. 89/ 2017, datë 22.5.2017 vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 46, datë 28.8.1997; nr. 58, datë 5.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 26.7.2012 dhe nr. 9, datë 26.2.2016.

¹⁵² Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, Ligji Nr. 37/2017 datë 30.03.2017, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 92, viti 2017.

¹⁵³ Ibid., neni 1.

ka arritur moshën 18 vjeç, ndërsa termi “i mituri në konfliktin me ligjin”, është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri në moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale. Ndërsa mosha minimale e përgjegjësisë penale” është mosha 14 vjeç në rastet e kryerjes së një krimi dhe mosha 16 vjeç në rastin e kryerjes së një kundërvajtjeje penale të parashikuar nga Kodi Penal. . Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se është i mitur, ai konsiderohet i tillë, në kuptim të këtij Kodi, derisa të përcaktohet mosha e tij.¹⁵⁴ Pra për dallim nga legjislacioni pozitiv i Shqipërisë, legjislacioni i Kosovës dhe i Maqedonisë në përkufizimin e nocioneve për sa i përket fëmijëve është më i kuptueshëm, konciz, i qartë dhe i harmonizuar sipas Konventës për të drejtat e fëmijëve e cila është nxjerr nga Organizata e Kombeve të Bashkuar (do të përdoret shkurtesa OKB-ja). Por KDPMSH-së, ka paraparë disa risi në emërtimin e disa nocioneve si “i mitur viktimë¹⁵⁵”, “i mitur dëshmitar”, “i ri” etj.

Si risi e Kodit të drejtësisë penale për të mitur i Shqipërisë është përcaktimi i Masave alternative.¹⁵⁶ Masat alternative për shmangien nga ndjekja penale mund të përfshijnë:

- programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi;
- këshillimin për të miturin dhe familjen;
- paralajmërimin me gojë;
- paralajmërimin me shkrim;
- masat detyruese;
- vendosjen nën kujdes.

Masat e shmangies duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me nevojat e të miturit në konflikt me ligjin dhe të viktimës. Asnjë detyrim nuk mund t’i imponohet të miturit në procesin e vendosjes së masës së shmangies, e cila mund t’i shkaktojë poshtërim, degradim, përjashtim nga

¹⁵⁴ Ibid., neni 7, parag. 3.

¹⁵⁵ Sipas nenin 3 të KDPMSH-së, I mitur viktimë” është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një veprë penale. I mitur dëshmitar” është çdo person nën 18 vjeç, i cili mund të ketë informacion lidhur me veprën penale. “I ri” është çdo person nga mosha 18 deri në 21 vjeç që akuzohet për kryerjen e një veprë penale, kur ka qenë i mitur.

¹⁵⁶ Sipas nenin 14 të KDPMSH-së, Masat alternative synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë. Kur bëhet ky vlerësim, nga çdo organ kompetent, në aktet respektive pasqyrohet mbajtja në vëmendje që masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal

procesi normal edukativ ose punësimi kryesor, si dhe dëmtim të shëndetit fizik ose mendor. Këto masa shqiptohen nga Prokurori dhe Gjykata.¹⁵⁷

Ndaj të miturit mund të caktohen edhe masat detyruese si: të kontaktojë ose takojë një person të caktuar, të shkojë apo vizitojë një vend të caktuar, të ndryshojë vendin e banimit, të largohet nga shtëpia gjatë një periudhe/orari të caktuar, të largohet pa leje nga një vend ose nga një rajon administrativ i përcaktuar, të kryejë ndonjë veprim tjetër që pengon rishoqërimin dhe rehabilitimin e tij. Ndërsa si masa detyruese konsiderohen edhe: të fillojë ose të rifillojë studimet në një institucion arsimor, fillojë të punojë, duke pasur parasysh dhe respektuar dispozitat e Kodit të Punës, të kryejë një program edukativ, korigjues ose mjekësor, të përmbushë detyrime të tjera që do të përforcojnë rishoqërimin e tij dhe parandalimin e rikryerjes së veprës penale.¹⁵⁸

Gjithashtu si masë alternative që mund t'i shqiptohet kryerësit të mitur të veprës penale është edhe Këshillimi për të miturin dhe familjen¹⁵⁹ dhe vendosja nën kujdes e të miturit¹⁶⁰

Sipas nenit 93 të KDPMSH-së, qëllimi i dënimit të të miturit është rishoqërimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje. Llojet e dënimeve për të mitur janë dënime me burgim dhe dënime me burgim. Dënime ndaj të miturve klasifikohen si dënime kryesore dhe dënime plotësuese¹⁶¹.. Si dënime kryesore konsiderohen: burgimi, kufizimi i lirisë¹⁶², dhe gjoba, ndërsa dënime plotësuese konsiderohen: qëndrimi në shtëpi, kryerja e një pune me interes publik, ndalimi për kryerjen e një veprimtarie dhe përmbushja e detyrimeve të caktuara.

Burgimi ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një vepër penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë. Për të miturin dënim me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet. Për përcaktimin e masës së dënimit për

¹⁵⁷ KDPMSH-së, neni 62, paragraf 1, 3 dhe 5.

¹⁵⁸ Ibid., neni 68, paragraf 1 dhe 2.

¹⁵⁹ Ibid., neni 65.

¹⁶⁰ Ibid., neni 69.

¹⁶¹ Ibid., neni 96.

¹⁶² Ibid., sipas nenit 98, Kufizimi i lirisë është vendosja e të miturit në një institucion/ qendër të caktuar nën mbikëqyrje pa u izoluar nga shoqëria dhe komuniteti, me qëllim edukimin dhe rehabilitimin përmes programeve të posaçme

të miturin, gjykata merr parasysh dhe i kushton vëmendje të veçantë të gjitha rrethanave që lidhen me shkallën e pjekurisë së të miturit dhe kohën që nevojitet për edukimin dhe formimin profesional. Megjithatë, në varësi të shkallës së fajësisë, dënimi mund të jetë më i shkurtër, kur vlerësohet se është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e tij. Gjukata, nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparshme e të miturit, mund ta përjashtojë atë nga dënimi. Në këto raste gjykata mund të vendosë dërgimin e të miturit në një institucion edukimi.¹⁶³

Nëse gjykata jep dënim me burgim deri në pesë vjet dhe i mituri nuk është dënuar më parë për kryerjen e një veprë penale me dashje, ajo mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Proves dhe të vihet në provë, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.¹⁶⁴

Krahasuar legjislacioni e pozitiv të Shqipërisë me Maqedoni dhe Kosovës për sa i përket kohëzgjatjes së dënimit me burgim për të mitur, del se politika ndëshkimore në Shqipëri është më rigorozë se me vende tjera. Kjo për faktin se delikuenca e të miturve në Shqipëri është në rritje apo kanë ndikuar faktorët të natyrave të ndryshme.

Sipas statistikave të Shqipërisë, del se gjatë viteve të fundit kriminalitetit i të miturve është në ulje. Kështu, gjatë vitit 2012, kanë qenë të dënuar 826 të mitur, gjatë viti 2013, 589 persona të mitur kanë qenë të dënuar, vitit 2014, janë dënuar 545 të mitur dhe gjatë viti 2015 janë dënuar 410 të mitur.¹⁶⁵ Veçori e viti 2015, është se më shumë të miturit kanë kryer krime se sa kundërvajtje nëse i krahasojmë me vitet paraprake. Pra marr në tërësi të gjitha vitet paraprake, lirisht mund të konkludojmë se kriminaliteti i të miturve në Shqipëri ka pësuar rënie. Një karakteristik tjetër e kriminalitetit të të miturve në Shqipëri është se numri më i madh i pjesëmarrjes në krimet delikuate të miturit janë të arsimuar. Gjithashtu është më rëndësi të trajtohet edhe gjinia femërore në pjesëmarrjen e delikuencës. Gjatë vitit 2012, kanë qenë të dënuar 226 të mitura të gjinisë femërore, gjatë viti 2013, 206 të mitura të gjinisë femërore kanë qenë të dënuar, vitit 2014, janë dënuar 232 të mitur të gjinisë femërore dhe gjatë viti 2015 janë dënuar 525 të mitur të gjinisë femërore.¹⁶⁶ Ndërsa gjinia më tepër e pranishme është gjinia mashkullore se sa femërore. Por vlen të theksohet se gjinia femërore është në rritje në kryerjen

¹⁶³ KDPMSH-së neni 97; KPSH-së, neni 51 dhe 53.

¹⁶⁴ KDPMSH-së, neni 104, parag 1.

¹⁶⁵ Vjetari Statistikor 2015, të publikuar nga Ministria e Drejtësisë, fq. 130.

¹⁶⁶ Ibid, fq. 137

dhe marrjen pjesë në kriminalitetin e të miturve gjatë viteve të fundit dhe kjo është mjaftë brengosëse.

Ndërsa sa i përket shqiptimit të dënimeve alternative është se gjatë vitit 2012 janë 455 të dënuar me alternativat e dënimit me burgim, të mitur, për vitin 2013 janë 326 të dënuar me alternativat e dënimit me burgim, të mitur, gjatë vitin 2014 janë 455 të dënuar me alternativat e dënimit me burgim, të mitur dhe gjatë vitit 2015 janë 415 të dënuar me alternativat e dënimit me burgim, të mitur. Masa e aplikimit të dënimi alternativ për të mitur ka ardhur në rritje përgjatë 4 vjetëve të fundit të veprimtarisë së shërbimit të provës dhe pika më e lartë është në vitin 2012 dhe 2014 me 455 urdhëra ekzekutimi. Një statistikë tjetër e rëndësishme është ajo që ka të bëjë me periudhën e provës. Nga vendimet gjyqësore që kemi për personat në mbikqyrje, periudha e provës që është dhënë nga gjykata për periudhën 2012 - 2015, për të dënuarit lëviz nga 18 muaj deri në 5 vjet. Në më të shumtën e rasteve gjykata ka vendosur si periudhë prove periudhën nga 18 muaj deri në 3 vjet e cila përbën 75.5% të rasteve.¹⁶⁷

¹⁶⁷ Ibid., fq. 151. Është më rëndësi të theksohet edhe një statistike e dekadës të delikuencës së të miturve. Gjatë dekadës 2005-2015 janë dënuar nga gjykatat penale pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë të mitur. Viti me më shumë raste të miturish nën dënim është viti 2012 me tetëqind e tetëdhjetë e tre raste. Mesatarja e të miturve të dënuar çdo vit është pesëqind e shtatëdhjetë raste çdo vit. Krimet në raport me kundërvajtjet penale të kryera nga të miturit janë më të shumta në numër. Në harkun kohor 2005-2015 janë dënuar të mitur për 4 886 krime dhe 810 kundërvajtje penale nga të miturit. Kjo statistik është marrë në faqen e internetit me datë, 06-06-2018. <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1882/Te-mitur-te-denuar-per-vepra-penale-2005-2015>

4 Procedura për ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj të miturve në entet edukative përmirësuese të Republikës së Shqipërisë

Në Shqipëri, pas ndryshimeve demokratike, janë bërë kthesa edhe në fushën e rregullimit ligjore të problematikës së ekzekutimit të sanksioneve penale, përkatësisht të vendimeve penale. Tani, në krahasimi me periudhën e diktaturës, problematika e ekzekutimit të dënimeve dhe masave të tjera, rregullohet me norma ligjore, duke u mbështetur në dispozitat kushtetuese, të Kodit penal, Kodit të procedurës penale dhe të Ligjit mbi ekzekutimin e vendimeve penale apo akteve tjera që në mënyrë të drejtpërdrejt rregullojnë këtë çështje.¹⁶⁸

Drejtësia e të miturve vlerësohet si pjesë e proceseve demokratike në një vend. Në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin synohet të shmanget sa të jetë e mundur ndërhyrja e sistemit të drejtësisë.¹⁶⁹

Ekzekutimi i dënimit me heqje lirie ose me burgim në Shqipëri ka rrugën e vetë të zhvillimit dhe transformimit. Mjetet dhe metodat e ekzekutimit të dënimit dhe mënyra e trajtimit të personave të dënuar gjatë qëndrimit në ente, që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar e deri në ditët e sotme, ishin në varësi nga rrethanat e caktuar shoqërore, ekonomike, politike, ideore, kulturore si dhe nga vetë qëllimi i dënimit.¹⁷⁰

Ekzekutimi i vendimeve për të miturit dhe gratë bëhet në vende dhe mënyra të veçanta e favorizues, të përcaktuara në këtë ligj ose me dispozita të tjera.¹⁷¹ Për vendimet penale me ekzekutim të menjëhershëm urdhërimet i jep gjykata që ka dhënë vendimin menjëherë pas shpalljes së tij.¹⁷²

Ekzekutimi i vendimit të dënimit jo me burgim, zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës¹⁷³. I mituri vazhdon të vuajë dënimin jo me burgim ose me kusht të

¹⁶⁸ Halili², fq. 275

¹⁶⁹ Hysi, Vasilika, Penologjia, Tiranë, 2012, fq. 310.

¹⁷⁰ Gashi, Rexhep³, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001, fq. 67.

¹⁷¹ Ligji, Nr. 8331 datë 21.04.1998 Për Ekzekutimin e Vendimve Penale, i ndryshuar me ligjin Nr. 10024, date 27.11.2008, neni 5.

¹⁷² Ibid., neni 11.

¹⁷³ Shërbimi i provës është organi shtetëror, që mbikëqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës, sipas këtij ligji dhe ndihmon në ekzekutimin e dënimit alternativ, si dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social. Për më gjerësih shih: nenin 107, të KDPMSH-së.

përcaktuar në vendimin e dënimit si i mitur edhe nëse ka mbushur moshën 18 vjeç para fillimit të ekzekutimit ose gjatë ekzekutimit të këtij vendimi.

Shërbimet në institucionet e paraburgimit dhe burgimit ku vendosen të pandehurit ose të dënuarit e mitur duhet të jenë në përputhje me kërkesat e respektimit të shëndetit dhe dinjitetit të të miturit dhe të jenë në funksion të rishoqërimit, riintegrit, rehabilitimit dhe parandalimit të rikryerjes së veprës penale ose të kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje. Për garantimin e interesit më të lartë të të miturit, institucioni përkatës i paraburgimit ose i burgimit duhet të ketë personel të mjaftueshëm, të specializuar dhe të trajnuar në vazhdimësi. Në personelin e institucioneve të paraburgimit dhe të burgimit për të mitur duhet të ketë të paktën një mjek, një infermier, një psikolog, një punonjës social. Sipas rastit, institucioni duhet të sigurojë mundësinë e një mjeku peditër, mjeku psikiatër ose çdo specialisti tjetër, sipas nevojave dhe sipas një regjimi kontrolli të përcaktuar. Të miturit në Institucionet e Ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur ose në seksionet për të miturit u garantohet mbikëqyrja dhe kontrolli vizual dhe/ose elektronik i të miturve.¹⁷⁴

Të miturit, si rregull, e kryejnë dënimin në institucione të posaçme vetëm për ta dhe, në pamundësi, në seksione të veçanta në Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (do të përdoret shkurtesa I EVP). Institucionet për të miturit apo seksionet për të miturit në I EVP sigurojnë lehtësi për të plotësuar nevojat individuale të të miturve të privuar nga liria. Institucionet për të miturit apo seksionet për të miturit në I EVP zbatojnë shkallën më të ulët të sigurisë dhe kontrollit, aq sa është e nevojshme për mbrojtjen e të miturve nga shkaktimi i vetëdëmtimeve, apo shkaktimi i dëmit ndaj personelit apo të tjerëve. Institucionet për të miturit apo seksionet për të miturit në I EVP ndërtohen ose organizohen për të përmbushur qëllimin rehabilitues nga privimi i lirisë, duke pasur parasysh të drejtën e të miturit për privatësi, stimulim shqisor, mundësi për shoqërim me të miturit e tjerë, pjesëmarrje në sporte, ushtrime fizike dhe argëtim.¹⁷⁵

Të dënuarit e mitur vendosen veçmas nga të dënuarit e rritur. Po ashtu ndalohet vendosja, mbajtja ose lëvizja e të miturit jashtë institucionit së bashku me një të rritur. Të dënuarat e mitura vendosen veçmas nga të paraburgosurit/të dënuarit meshkuj të mitur. Në mënyrë që të sigurohet mjedis i sigurt për të miturit në institucionin seksionin për ta, të miturit

¹⁷⁴ KDPMSH-së, neni 110.

¹⁷⁵ Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve në Shqipëri, neni 75.

ndahen në bazë të grupmoshës, llojit dhe rëndësisë së veprës penale, zhvillimit fizik dhe mendor, si dhe karakteristikave të tjera duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të të miturit.¹⁷⁶ Një risi në legjislacioni pozitiv të Shqipërisë është se për realizimin e të drejtave në procesin e ekzekutimit të dënimit i mituri i caktohet mbrojtës sipas dispozitave të Kodit dhe legjislacionit në fuqi.¹⁷⁷

Vendosja e kategorive të ndryshme të të miturve në institucione bëhet në bazë të nevojave të veçanta dhe mbrojtjes së integritetit fizik, mendor, si edhe mirëqenies së të miturit. Të miturit vendosen në institucione që janë pranë vendbanimit të familjes së tyre apo vendeve që shërbejnë për ri-integrimin e tyre shoqëror. Në momentin e pranimit, të miturit informohen për rregulloren e brendshme të institucionit dhe për të drejtat dhe detyrimet e tij në një gjuhë dhe mënyrë të kuptueshme. Menjëherë pas pranimit, i mituri i nënshtrohet kontrollit mjekësor nga personeli mjekësor brenda 24 orëve dhe për të hapet dosja mjekësore, ku regjistrohet trajtimi i sëmundjeve apo dëmtimeve. Për vendosjen e të miturit në institucion, merr vendim drejtori i IEVP-së, i cili përcakton nivelin e përshtatshëm të sigurisë, që mund të rishikohet më pas dhe llojin e programit individual për të. Në çdo institucion ku vendosen të mitur, ngrihet dhe funksionon një sistem vlerësimi për klasifikimin e të miturve në përputhje me nevojat e tyre edukuese, zhvillimore dhe të sigurisë. Kriteri kryesor për klasifikimin e kategorive të ndryshme të të miturve është lloji i përkujdesjes që i përmbush më mirë nevojat individuale të një të mituri, si edhe mbrojtja e integritetit dhe mirëqenies së tyre fizike, mendore e morale.¹⁷⁸ Gjithashtu edhe higjiena dhe ushqim duhet të jetë adekuat sipas nevojave për të mitur.¹⁷⁹

I mituri ka të drejtë të kryejë një punë që shpërblehet. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur nxit kryerjen e punës së shpërblyer. Kur është e mundur, i dënuari i mitur mund të punojë edhe jashtë këtij institucioni, duke respektuar dispozitat e Kodit të Punës lidhur me punësimin e të miturve. I mituri punon jashtë kohës së studimit. Kohëzgjatja e punës dhe e edukimit të të miturit nuk duhet të kalojë 8 orë në ditë.¹⁸⁰

¹⁷⁶ KDPMSH-së, neni 113.

¹⁷⁷ KDMPH-së, neni 112.

¹⁷⁸ Rregullat e përgjithshme të burgjeve në Shqipëri, neni 77, 78, 79, 80; KDPMSH-ë, neni 114 dhe 115.

¹⁷⁹ Për më gjerësiht shih: Rregullat e përgjithshme të burgjeve në Shqipëri, neni 82 dhe 83; KDPMSH-së, neni 116.

¹⁸⁰ KDPMSH-së, neni 118; Rregullat e përgjithshme të burgjeve në Shqipëri, neni 89.

Për çdo të mitur të privuar nga liria hartohet një plan individual rehabilitimi dhe ri-integrimi, duke marrënë konsideratë vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, nivelin arsimor, dëshirat dhe mundësitë e tij për të ndjekur kurse profesionale ose për të përparuar në arsimim.¹⁸¹

I mituri i dënuar mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit vetëm nëse ka kryer: jo më pak se një të tretën e dënimit me burgim, në rast se është dënuar me burgim deri në 3 vjet; jo më pak se një të dytën e dënimit me burgim, në rast se është dënuar me burgim deri në 8 vjet; jo më pak se dy të tretat e dënimit me burgim, në rast se është dënuar me burgim mbi 8 vjet. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të miturit, jo më vonë se tre muaj nga data më e afërt e lirimit me kusht, njofton Shërbimin e Provës mbi mundësinë e lirimit të të miturit. Shërbimi i Provës analizon sjelljen e të miturit gjatë kryerjes së dënimit, faktet e të dhënata kriminale të veprimeve të kryera në të kaluarën, personalitetin e të miturit, kushtet familjare, natyrën e krimit të kryer prej tij dhe rrethana të tjera, të cilat mund të ndikojnë në dhënien e vendimit për lirimin e parakohshëm. Gjykata, me vendim të arsyetuar, vendos pranimin ose refuzimin të kërkesës për lirimin me kusht të të miturit.¹⁸²

¹⁸¹ Rregullat e përgjithshme të burgjeve në Shqipëri, neni 86.

¹⁸²Për më gjerësisht shih: KDPMSH-së, neni 129 dhe 130.

PËRFUNDIMI

Ekzekutimi i dënimit me burgim, për fat të mirë, ka evoluar në krahasim me kohën kur ka filluar që të ekzekutohet ky dënim. Tani ekzekutimi i këtij dënimi nuk konsiderohet si hakmarrje, por si ndëshkim për veprën të cilën e ka kryer i mituri dhe qëllimi i këtij dënimi është rehabilitimi dhe kthimi i të miturit në shoqëri si anëtar i dobishëm. Dënimi me burgim është dënimi me i rëndë që ekzekutohet ndaj të miturve, sepse gjatë ekzekutimit të këtij dënimi të miturve i'u kufizohen shumë të drejta që janë shumë të rëndësishme për të miturin, siç është e drejta e qarkullimit apo lëvizjes. Andaj ky dënim duhet të përdoret vetëm si masë e fundit, me tëpër t'ju jepet hapësirë masive edukative. Gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim personeli i burgjeve duhet të bëjë punë më të madhe lidhur me trajtimin e tyre, sepse nga ky trajtim varet edhe përmirësimi i të miturve. Po ashtu personeli i burgjeve për të mitur duhet të jetë profesional dhe i përgatitur mirë. E gjithë puna që bëhet gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim duhet të fokusohet në riedukim dhe në risocializim të të miturit, sepse nëse nuk arrihet ky rezultat, atëherë i mituri shumë lehtë në të ardhmen mund të jetë recidivist dhe i dëmshëm për shoqërinë ku jeton.

Gjithashtu gjatë trajtimit të kësaj problematike, e vërejmë se legjislacioni pozitiv i Kosovës lidhur me trajtimin e të miturve është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare, por, gjendja faktike në vend është krejt ndryshe se çka përcakton ky legjislacion. Por në tërësi nëse e analizojmë situatën lidhur me ekzekutimin e sanksioneve penale ndaj të miturve edhe në vendet e rajonit, mund të përfundojmë se ligjet pozitive pothuajse në të gjitha këto shtete kanë ndryshuar dhe janë harmonizuar sipas akteve ndërkombëtare. Por ngjasje më të madhe si në Kosovë ashtu edhe në vendet e rajonit është trajtimi i të miturve gjatë arrestimit apo ndalimit si dhe gjatë trajtimit të të miturve gjatë vuajtjes së dënimit me burgim apo ekzekutimit të ndonjë mase edukative.

I mituri gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim ka beneficione të ndryshme, mirëpo mendoje se këto beneficione duhet të jenë më të mëdha, sepse ndikojnë më tëpër në riedukim të tij.

REKOMANDIMET

Sistemi penitensiar ndaj të miturve si e vërejtëm paraqet një ndër sfidat më të mëdha në shoqërinë Kosovare por edhe në rajon. Këto sfida kanë të bëjnë që në fazën e parë kur i mituri kryen ndonjë sjellje deviante e cila nuk ka marr akoma karakterin e veprës penale. Në këtë stad jo vetëm Kosova, por edhe Shqipëria dhe Maqedonia nuk kanë arrit që të përcaktojnë një politik të mirëfilltë drejt prevencionit të delikuencës. Kështu gjata trajtimit të kësaj materie kemi arrit në disa rekomandime të cilat pak a shumë do të kontribuojnë në rregullimin e kësaj problematike. Si rekomandime mund të konsiderohen:

- Sistemi i drejtësisë në Kosovë duhet të bëjë reforma adekuat si në aspektin funksionale, organizativ dhe profesional.
- Kodi i Drejtësisë për të mitur i Kosovës duhet të ndryshoj dhe të parasheh disa masa parapenale, në raste kur i mituri kryen ndonjë sjellje devijante sepse është më rëndësi që në këtë fazë të parandalohet i mituri që në të ardhmen të mos kryej ndonjë vepër penale.
- Në Kosovë duhet që sa ma shpejt të themelohen institucione edukative të veçant, ku ekziston mundësia e ekzekutimit më adekuat të masave edukative që shqiptohen ndaj të miturve.
- Në institucionin korrektues në Lipjan, duhet të rekrutohen persona që kanë njohuri dhe përgatitje nga fusha e psikologjisë, sociologjisë, pedagogjisë, kriminologjisë dhe penologjisë, dhe jo persona të cilët nuk kanë njohuri elementare për trajtimin e të miturve.
- Në Maqedoni duhet të ndryshohet Kodi i drejtësisë për të mitur, i cili duhet të parasheh masat e diversitetit dhe në mënyrë tekstative të bëjë renditje e të gjitha masave që si model mund të ketë legjislacionin e Kosovës.
- Në Shqipëri edhe pse në vitin 2018 ka arrit që të hartoj një ligj të veçantë mbi trajtimin e të miturve, akoma ka problem shumë sidomos gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të miturve. Pra duhet të ndërtohen institucione të veçanta ku mund të ekzekutohen edhe dënimet por edhe masat edukative. Sepse nëse e analizojmë statistikën në Shqipëri vërejmë se kriminalitetin e të miturve është në rritje.

LITERATURA

Gashi, Regjep¹, Ekzekutimi i Dënimeve Alternative, Prishtinë, 2013.

Gashi, Rexhep², Lirmi me kusht i personave të dënuar në legjislacionin dhe në praktikën Kosovare, Revista, “E drejta”, nr. 2/2004, Prishtinë.

Gashi, Rexhep³, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001.

Hajdar, Azem, E drejta e procedurës penale e të miturve, Prishtinë, 2005.

Halili, Ragip¹, Kriminologjia, Prishtinë, 2011.

Halili, Ragip², Penologjia, Prishtinë, 2014.

Hysi, Vasilika, Penologjia, Tiranë, 2012.

Kambovski Vlado, E drejta penale – Pjesa e përgjithshme (E përkthyer në gjuhën shqipe nga Osmani Afrim dhe Zejneli Ismail), Shkup, 2010.

Musliu, Betim. Gashi Ademi, “Falja në Kosovë – Analizë e zbatimit të institutit të faljes dhe lirit me kusht”, të publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, Prishtinë, 2012.

Sahit, Ejup, Murati, Rexhep, E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, 2013.

Salihu Ismet., Zhitija Hilmi., Hasani Fejzullah, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të botuar nga Organizata Gjermane GIZ, 2014.

Salihu, Ismet¹, E drejta Penal për të mitur, Prishtinë, 2010.

Salihu, Ismet², E drejta Penale-pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2013.

Sufaj, Femi, “Sistemi i drejtësisë për të mitur në Shqipëri krahasuar me standardet ndërkombëtare”.

Ukaj, Bajram, Sanksionet penale ndaj të miturve në Ligjin penal për të mitur të Kosovës të vitit 2004, , Revista, E drejta, nr.1-2/2008. Prishtinë.

Zejneli Ismail², Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë, Tetovë, 2010.

Zeneli, Ismail¹, Kriminaliteti i të miturve dhe trafikimi i drogës në Maqedoni, të botuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Revista “E drejta”, nr. 3/2003, Prishtinë.

Burimet ligjore

Kodit të Drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-193, të botuar në Gazetën Zyrtare, Prishtinë, Viti V, Nr. 78, të datës 20 gusht 2010.

Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, Nr.03/L-191, të botuar në Gazetën Zyrtare, Nr. 79/2010.

Ligi mbi drejtësinë për të mitur i Republikës së Maqedonisë, të publikuar në Gazetën zyrtare të RM, nr. 87.2007.

Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ne Republikën e Kosovës, Nr.04/L-149, G.Z.K, 31/2013, të publikuar me datë, 28.08.2013 dhe Ligji Nr. 05/L-129 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit me Nr. 04/L-149, të publikuar në G.Z.K, datë 11.05.2017.

Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat Themelore të Kosovës.

Kodi Penal I Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-082, të publikuar në G.Z.K, Nr. 19/2012.

Ligji, Nr. 8331 datë 21.04.1998 Për Ekzekutimin e Vendimve Penale, i ndryshuar me ligjin Nr. 10024, date 27.11.2008.

Ligji, Nr. 7895, datë, 27.01.1995, Kodi Penal i Shqipërisë, i përditësuar dhe ndryshuar me ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.4.1997; nr. 8279, datë 15.1.1998; nr. 8733, datë 24.1.2001; nr. 9017, datë 6.3.2003; nr. 9030, datë 13.3.2003; nr. 9086, datë 19.6.2003; nr. 9188, datë 12.2.2004; nr. 9275, datë 16.9.2004; nr. 9686, datë 26.2.2007; nr. 9859, datë 21.1.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr. 23/2012, datë 1.3.2012; nr. 144, datë 2.5.2013; nr. 98, datë 31.7.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/ 2015, datë 5.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.7.2016; nr. 36/2017, datë 30.3.2017; nr. 89/ 2017, datë 22.5.2017 vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 46, datë 28.8.1997; nr. 58, datë 5.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 26.7.2012 dhe nr. 9, datë 26.2.2016.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, Ligji Nr. 37/2017 datë 30.03.2017, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 92, viti 2017.

Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve në Shqipëri.

Rregullave të Pekinit, të miratuar nga Asambleja e përgjithsme e Kombeve të bashkuar me 29 nëntor të vitit 1985, me Rezolutën nr. 40/33.

Udhëzimet Kombeve të Bashkuar për parandalimin e delikuencës së të miturve (Udhëzimet e Riadit), të miratuar dhe të shpallur me Rezolutën 45/112 të Asamblesë së Përgjithshme më 14 dhjetir 1990, sesioni 68-të plenar.

Rregullat e Kombeve të Bahkuar për mbrojtjen e të miturve që janë privuar nga liria.

Rregullat minimale standarde të OKB-së për trajtimin e të burgosurve, të adoptuar nga Kongresi I i Kombeve të Bashkuar për parandalimin e krimeve dhe trajtimin e delikuinteve, mbajtur në Gjenevë, më 1995 dhe miratuar nga Këshilli ekonomik e shoqëror me rezolutat e tij 663C (XXIV) të datës 31 korrik 1957 dhe 2076 (LKII) të datës 13 maj 1977.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, miratuar dhe shpalur nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën e saj 217 A(III) të datës 10 dhjetor 1948.

Konventa kundër torturës dhe dënimeve a trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën e saj 39/46 të 10 dhjetorit 1984.

Konventa mbi të Drejtave të Fëmijëve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuar me 20 nëntor 1989.

Raportet të ndryshme.

Shërbimi Sprovues i Kosovës, Buletini, Nr. 8, 2013.

Vjetari Statistikor 2015, të publikuar nga Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë.

Agjensioni i Statistikave të Kosovës, “Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur 2014.

Agjensioni i Statistikave të Kosovës, “Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur”, 2015

Agjensioni i Statistikave të Kosovës, “Statistikat e Jurisprudencës për personat e mitur”, 2016.

Prezantimi i programit i të miturve në konflikt me ligjin nga Organizata ndërkombëtare joqeveritare, Therre Des Hommes.

Aktvendimin PM. Nr. 116/2014 të Gjykatës themelore në Prizren.

Aktvendimin PM. Nr. 115/2014 të Gjykatës Themelore në Prizren.

Aktgjykimin PM. Nr. 256/2013 të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Aktgjykimin PM. Nr. 313/2011 të Gjykatës Themelore të Pejës.

Qëndrimin Parimor të Gjykatës Supreme Agj. Nr. 314/2012.

Burime terciare

https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2346955, dt. 27-05-2018. Autori,: Öberg Jacob, The definition of criminal sanctions in the EU, European Criminal Law Review 3 (2013) 273 , fq. 2-8, të marrë me datën: 02-04-2018.

<http://ask.rks-gov.net/> të marrë me datën: 24-04-2018.

<http://archive.koha.net/?id=&l=135966>, të marrë me datën: 15-05-2018.

https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/human_rights_strategy_for_kosovo_2016-2022_alb.pdf, të marrë me datën: 01-06-2018.

<http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/page/index/389>, të marrë me datën: 22-05-2018.

https://www.unicef.org/albania/sq/children_28174.html, të marrë me datën: 05-06-2018.